

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 234, Prill 2023

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Kandidatet për kryetar të bashkisë Shkodër, në zgjedhjet e 14 majit 2023



**Benet Beci - Partia Socialiste**



**Bardh Spahija - e Djathta**

### "AT GJERGJ FISHTA - I KOMBIT DHE I ZOTIT"

Simpozium historik kushtuar jetës dhe veprës së poetit tonë të shquar Gjergj Fishta "Nderi i Kombit"

Shoqata "Nënë Tereza" me qendër në Namur të Belgjikës, është një nga organizatat më aktive në zemër të Evropës, e cila me veprimtaritë e saja ka dëshmuar frymën e saj të atdhetarisë dhe seriozitetin e punës në promovimin e vlerave kombëtare shqiptare para Evropës dhe botës.

4

### Kryeredaktori i gazetës "Dukagjini" dhe publicisti i njohur, Prele Milani, fitues i Çmimit "Hamit Boriçi", edicioni i 6-të

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dega Qarku Shkodër, zhvilloi këto ditë edicionin e gjashtë të ndarjes së çmimeve vjetore "Hamit Boriçi" për gazetarët e Shkodër. Një aktivitet ky tashmë i rruar në tradicional për gazetarët...

5

### Federata e Paqes Universale në Shqipëri, në Shkodër

Federata Universale e Paqes (UPF), një rrjet ndërkombëtar dhe ndërfaqësor i individëve dhe organizatave, duke përfshirë përfaqësues nga feja, qeveria, shoqëria civile dhe sektori privat, i është përkushtuar arritjes së paqes botërore. Një OJQ në status të përgjithshëm konsultativ me Komisionin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara, UPF...

6

### KUSH JANË SHQIPTARËT?

- Artikulli i të famshmes "National Geographic"-

Shqiptari është evropian: për më shumë se dy mijë vjet ka jetuar atje ku jeton tani - në fortesat e Epirit dhe Ilirisë, përtej Adriatikut paralel me thembrën e Italisë. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shqiptarët u përzier me fqinjët e tyre jugorë, grekët dhe ishin shtylla kurrizore e luftës për Pavarësinë e Greqisë. Bashkatdhetarët e Marko Boçarit emigruan...

10



# Kandidatet për kryetar të bashkisë Shkodër, në zgjedhjet e 14 majit 2023

## Kush është Benet Beci?

Benet Beci ka kryer studimet universitare në Fakultetin e Ekonomisë në vitin 1987, ato master në Administrim Biznesi, me një temë mbi sistemin bankar në vitin 2003 dhe doktoraturën në vitin 2015, me një temë mbi zhvillimin rajonal. Ai ka kryer edhe një sërë specializimesh të tjera brenda dhe jashtë vendit, kryesisht në sistemin bankar dhe atë të mikrofinancës, analizës financiare e menaxhimit të risikut, por edhe mbi partneritetet publiko-private dhe inovacionet në qeverisje.

Gjatë karrierës së tij, Benet Beci, numëron detyra të rëndësishme, duke filluar nga ajo në Ministrinë e Transporteve, ku për 5 vite ka mbajtur detyrën e inspektorit të tarifave dhe standardeve. Më pas, në vitin 1992 ka punuar në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë në Bankën Kombëtare (sot Banka e Shqipërisë).

Nga viti 1993 deri në vitin 2005 z. Beci ka punuar në institucione financiare të ndryshme si Banka Kombëtare Tregtare, Fondi i Financimit Rural dhe Unioni i Shoqatave të Kursim Kredisë. Po ashtu ai ka qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si dhe anëtar i Komitetit të Kontrollit të Bankës së Kreditit të Shqipërisë. Detyra më e rëndësishme dhe afatgjatë ka qenë ajo e drejtorit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, një institucion publik që implementon projekte zhvillimi në nivel lokal dhe kombëtar.

Benet Beci e mori drejtimin e FSHZH në vitin 2005, në kohën kur portofoli i këtij institucioni ishte rreth 116 milionë Euro. Gjatë drejtimit të tij ky portofol u rrit në më shumë se 480 milionë euro, ose 8 herë më shumë. Nga viti në vit aktiviteti i FSHZH u zgjerua duke u transformuar nga një institucion me aktivitet kryesisht në zonat rurale, në instrumentin më të besuar të donatorëve për investime në të gjithë territorin e vendit në infrastrukturë, turizëm, bashkëpunim ndërkufitar etj. Donatorët e mëdhenj si Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka e Këshillit të Evropës, e të tjera, i kanë besuar FSHZH projektet kryesore të zhvillimit. Rreth 20 programe madhore dhe 2 100 projekte në funksion të zhvillimit të infrastrukturës, turizmit, kulturës janë realizuar me sukses gjatë këtyre 13 viteve. Në janar të vitit 2019 ai u emërua administrator i Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, ku administroi me sukses dhe transparencë situata komplekse gjatë periudhës së pandemisë, si ajo e prurjeve ekstreme të reshjeve në periudhën dhjetor 2020-prill 2021. Në këtë periudhë u ndërmorën për herë të parë në historinë e KESH, hapa konkretë për shtimin e kapaciteteve të reja prodhuese si impianti fotovoltai në digën e Vaut të Dejës, hapat e parë për projektin e hidrocentralit të Skavicës, e të tjera. Gjithashtu, po për herë të parë një korporatë publike përgatiti një strategji për përgjegjësinë



Kandidati Benet Beci për Kryetar të Bashkisë së Shkodrës i propozuar nga PS-ja

sociale të saj, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me komunitetet ku ajo ka ndikim, veçanërisht bashkitë Shkodër e Vau i Dejës. Gjatë kësaj kohe u hartua projekti i rrugës së Komanit, ai i forcimi të turizmit përgjatë kaskadës, si dhe u mbështetën një sërë projektesh mjedisore, sociale e kulturore të organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në këtë territor. Këtë detyrë z. Beci e mbajti për gati dy vjet, deri në prill të vitit 2021, kur garoi për deputet nën siglën e Partisë Socialiste.

Shkodra ka qenë arsyeja, pse kam pranuar që në fillim të hyja në politikë. E kam thënë shpesh, s'ka qenë vendim i lehtë, por që pikërisht mundësia me kontribuua për qytetin që më bindi edhe herën e parë. Në parlament nuk arrita me e gjetë hapësirën që duhet me çua punët përpara. Unë jam njeri i punës, i projekteve, jo i fjalëve. Ndaj ftesa me kandidua për Kryetar të bashkinë Shkodër, ishte një dritë që mu ndez, një mundësi që gjithë çfarë di e çfarë kam përvojë ta përkthej në një projekt konkret për qytetin e rrënjëve të mia.

Unë po kërkoj që Shkodra t'i besojë projektit tim. Unë nuk vij këtu të them, më votoni mua se Rama do na e bëjë fushë me lule...nuk jam unë ai lloj politikani, madje me thënë të drejtën as dua të jem politikan. Të doja rrija "rehat" si deputet, dhe vija flisja në emër të partisë apo drejtuesit të saj. Unë s'e dua këtë, nuk u bëra dot palë kurrë me këtë. Unë dua të bëj atë që di të bëj, të nis projekte, të bëjmë bashkë njerëz të aftë, të ndërtoj ekipe të qëndrueshme, të hartojmë plane konkrete e të thithim donatorë e investitorë strategjikë, do të jetë edhe qeveria njëri prej tyre, s'kam asnjë kompleks për këtë përkundraz. Madje pikësynimi im ky është, ta

kthejmë Shkodrën në bashkinë kampione në vend, për sigurimin e fondeve për tu bërë qendra rajonale e zhvillimit, e turizmit, e kulturës e trashëgimisë. Bashkinë që hap vende pune, forcon ekonominë, zhvillon territorin dhe që ka një qëllim, të bëjë Shkodrën qytetin ku të rinjtë duan të kthehen.

Shkodra dhe të gjithë ne jemi sot në një udhëkryq të rëndësishëm: ose duhet të merremi seriozisht me shfrytëzimin e pasurive të mjaftueshme natyrore e njerëzore dhe t'i vëmë në shërbim të gjithë banorëve ose të pajtohemi me qenien në periferinë e zhvillimeve evropiane dhe kombëtare, siç fatkeqësisht jemi sot. Ne nuk mund të presim që dikush tjetër në Tiranë a kudo tjetër ta marrë këtë rol për ne, duhet të marrim menjëherë vetë në dorë frenat e zhvillimit të Shkodrës.

Vetëm duke ndërtuar mbi të ardhmen e jo mbi të shkuarën, mbi pozitiven e jo negativën, të motivuar nga dëshira për mirë e jo nga urrejtja për të tjerët, mbi bashkëpunimin e jo konfliktin, ne mundemi ta ndërtojmë ëndrrën tonë të përbashkët të një Shkodre, për të cilën të jemi krenarë, jo vetëm për atë që ishte në të shkuarën, por për atë që është sot e atë që do jetë nesër.

Bashkia, shtëpia e përbashkët e të gjithë shkodranëve, duhet të marrë përsipër rolin që i takon në planifikimin, skicimin e së ardhmes, si dhe të hartimit të projekteve, lobimit për mbështetjen e tyre dhe ndërtimin e një vizioni të ri dinamik, bashkëpunues dhe pozitiv për bashkinë.

## Drejtimet kryesore të punës së Benet Becit:

Do të jenë tre drejtime kryesore si parime udhëheqëse të punës sime si kryetar i Bashkisë Shkodër:

\*Bashkia forcon ekonominë.

\*Bashkia është në punë.

\*Bashkia është e hapur për të gjithë.

## Bashkia si aktor qendror i zhvillimit ekonomik.

Kryefjala për suksesin në Shkodër është ekonomia. Përmirësimi i ekonomisë në qytet, nuk është një slogan për hatër të një programi që duhet prezantuar. Është një nevojë, një bindje, një domosdoshmëri. E thonë të gjithë, në çdo takim, në çdo bisedë, në çdo biznes. Ekonomia, ekonomia, ekonomia. Kjo është e vetmja rrugë. Turizmi, tregu dhe zhvillimi duhet të jetë në Shkodër jo pse ne jemi shkodranë, por se gjithë graviteti historik dhe qendra rajonale e gjithë kësaj zone ka qenë Shkodra.

Ne nuk bëjmë asgjë veçse kthejmë atë që i takon, atë që duhet, atë që natyrshëm

ndodh e kthejmë në Shkodër dhe për këtë duhet një projekt, investime, bashkëpunim e të jemi gati. Unë e shoh që ka energji në Shkodër, e vonuar ka qenë përpjekja për ta filluar këtë projekt, por ndoshta tani është koha e duhur për të filluar një aksion të fuqishëm të qeverisë me bashkinë dhe donatorët të koordinuara dhe me çdo faktor që i shkon për qasje zhvillimit për ta bërë këtë pikë të Shqipërisë një rajon, i cili ka rrezatim përtej kufijve të vet, një rrezatim natyral e historik të të gjithë rajonit, siç do të jetë së shpejti rikonstrukcioni I rrugës ekzistuese të Dukagjinit: Mes-Prekal-Kir-Mali i Shoshit-Ura e Re e Shalës-Breg Lumi e Nderlyasaj.

Do të punojmë për një ekonomi më të fortë, për më shumë vende pune dhe vende pune më të mira. Vetëm me një ekonomi më të fortë, do të kemi një shoqëri më të begatë, të arsimuar, të kulturuar e të zhvilluar.

Për një ekonomi të forcuar bashkia do të punojë për Investime publike dhe private të shumëfishuara. Një grup i përqendruar i investimeve publike në territorin e Bashkisë me fonde të qeverisë, donatorëve e bashkisë. Nxitja me çdo kusht e investimeve private, për një ekonomi shumë më dinamike gjithashtu. Të gjitha këto ndërhyrje të propozuara jam i sigurt se do ta bëjnë Shkodrën një destinacion turistik më të avancuar dhe bashkinë me rritjen më të shpejtë të turizmit në vend. Do të krijojmë vende të reja tërheqëse pune dhe mundësi për biznese të reja. Shkodra do të jetë në rrugën që i takon për të qenë, zemra ekonomike e rajonit.

Është e vërtetë që disa punë në bashkinë tonë mund të bëhen vetëm me bashkëpunimin e qeverisë shqiptare dhe donatorëve të huaj, por është po aq shumë e vërtetë se ka plot punë të tjera që mund të bëhen duke u organizuar shumë më mirë vetë. Kemi nevojë të ndërtojmë një bashki që bën punët e shtëpisë mirë dhe shpejt. Të ndërtojmë një bashki eficientë, që bën plane dhe ekzekuton "pa u menduar" procese pune rutinë.

Jemi me fat që kemi një bashkësi të madhe, të ri, të mirë shkolluar. Kemi të gjitha mundësitë që punonjësit e bashkive, një pjesë e të cilëve sigurisht kanë përvojë dhe aftësi të lavdërueshme, mund të bëjnë punë shumë më të mirë dhe më tepër me drejtimin e duhur. Nga ana tjetër bashkia dhe ndërmarrjet e varësisë nuk ka asnjë arsye të jenë çerdhe militantësh partiakë, por do të kenë në pozicione drejtues profesionistë me përvojën dhe arsimimin e duhur.

Në shumë pak kohë do të kemi rezultate të prekshme në të gjithë shërbimet bazë që ofron bashkia. Ndërsa projektet konkrete, me të mbyllur takimet me grupet e interesit, do t'i propozoj shumë shpejt, edhe në takimet e drejtpërdrejta me qytetarët, edhe në media, edhe ne [www.shkodrapozitive.com](http://www.shkodrapozitive.com).

Redaksia e gazetës



# Bardh Spahia për kandidat Kryetar të bashkisë së Shkodrës, i propozuar nga koalicioni Bashkë Fitojmë

## Kush është Dr. Bardh Spahia?

Dr. Bardh Spahia, lindur në Shkodër, më 29 Janar 1976, është i martuar dhe ka 2 fëmijë. i diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Dr. Spahia është mjek kirurg. Ai ushtroi profesionin e kirurgut në Pavia dhe Milano të Italisë. Është i vetmi anëtar nga Shqipëria i Circolo "Esperia", një organizatë e themeluar në Bruksel në 2020-ën nga disa anëtarë të shquar të Partisë Popullore Evropiane.

Dr. Bardh Spahia rrjedh nga një familje e persekutuar nga regjimi komunist, familje me vlera të shquara intelektuale dhe profesionale. Në fillim të viteve '90, i ati, doktor Ali Spahia ishte ndër nismëtarët e ndryshimeve demokratike në vend, duke qenë ndër më aktivët që në ditët e para të krijimit të Partisë Demokratike.

Dr. Bardh Spahia, ndoqi shembullin e të atit, duke u bërë pjesë aktive në lëvizjen demokratike me 2 prill 1991, si nxënës i gjimnazit "Jordan Misja". Dr. Bardh Spa-



hia është bashkëautor i mjaft publikimeve profesionale në fushën e mjekësisë.

Dr. Spahisë i janë besuar edhe detyra të rëndësishme: Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Zëvendësministër i Shëndetësisë gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike. Ai ka shërbyer dhe ne detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës.

Në vitin 2017, Dr. Spahia është zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë, përfaqësues i Qarkut të Shkodrës.

Në punën e tij si mjek kirurg, por edhe në pozicione të tjera drejtuese, Dr. Spahia ka treguar karakter të fortë, vendosmëri në realizimin e synimeve, profesionalizëm, humanizëm dhe mbështetje sidomos për personat në vështirësi shëndetësore.

Pas procesit të parë të primareve në Shqipëri mbajtur me 30 Janar 2022, Dr. Bardh Spahia është zgjedhur kryetar i Bashkisë Shkodër, me 6 mars 2022 dhe ka marrë zyrtarisht detyrën me 31 mars 2022.

Redaksia e gazetës

## U realizua Festivali i III Mbarë shqiptar i Poeteshave

Poeteshat, me vargjet e tyre bënë, që lulet të çelin në Shkodër dhe të shpërndajnë aromë nga Tirana, Saranda, Korça, Vlora, Prishtina, Deçani, e të tjera. Dukej sikur puhiza e Liqenit të Shkodrës përkëdhelte me ëmbëlsi poeteshat. Kështjella "Rozafës" shpërndante atmosfere kulturore shqiptarie. Dukej se Shqipëria dhe Kosova kishin fshire kufijtë. Ky Festival u organizua nga Lëvizja vullnetare "Gratë Frymojnë Vlera".

Na nderuan me pjesëmarrjen e tyre Kryetari i Shoqatës së Shkrimtareve Shkodër z Zija Vukaj, i cili e vlerësoi këtë Festival, na përgëzoi për organizimin, shprehu respekt për të gjitha poeteshat, dhe Kryetari i Shoqatës së Shkrimtareve të Sarandës z Pajtim Çausi, i cili krahas

falënderimit për ftesën ftoi poeteshat të jenë pjesë në veprimtaritë, që realizon shoqata e tij.

Në këtë Festival nder 52 poezi u përzgjedhën 25 prej tyre, të cilat iu nënshtruan vlerësimit nga juria.

- Çmimi i Parë, Melita Vjerdha - Shkodër

- Çmimi i Dytë, Shefqete Gosalci - Prishtinë

- Çmimi i Tretë, Natasha Xhelili - Sarandë

- Çmim Specia, Meri Mezini - Tiranë

- Çmim Special nga Lëvizja "Gratë Frymojnë Vlera" Klevisa Bardeli - Shkodër

Tre Çmimet ishin të vlerësuara dhe Çmimi i parë special nga juria prestigjioze: Rozafa Shpuza, poete tashme e

mirënjohur në mbarë shqiptarinë vlerësuar disa here me çmime të ndryshme, Ermira Alija- Pedagoge në Departamentin e Letërsisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" dhe Zyrafete Shala - Kryetare e Shoqatës së Shkrimtareve, në Ferizaj.

Fjala të bukura e përgëzuese nga poeteshat për organizimin dhe vlerësimin nga

juria profesionale.

Në fund të veprimtarisë u shtrua një dreke ku poeteshat patën mundësi të argëtohen. Dukej sikur gjithë poeteshat ishin shkodrane, ishin miqësore, ishin plot buzëqeshje dhe plot shprese për të vijuar përsëri këto eksperiencia të bukura.

Farida Zmijani Ramadani





# “AT GJERGJ FISHTA - I KOMBIT DHE I ZOTIT”

**Simpozium historik kushtuar jetës dhe veprës së poetit tonë të shquar Gjergj Fishta “Nderi i Kombit”**

Shoqata “Nënë Tereza” me qendër në Namur të Belgjikës, është një nga organizatat më aktive në zemër të Evropës, e cila me veprimtarite e saja ka dëshmuar frymën e saj të atdhetarisë dhe seriozitetin e punës në promovimin e vlerave kombëtare shqiptare para Evropës dhe mbarë botës.

Veprimtaria e radhës ishte pasditen e dates 1 Prill 2023, në një sallë komunitare të tejmbushur me pjesëmarrës, organizimi i një simpoziumi historik, me temë “At Gjergj Fishta i Kombit dhe i Zotit”.

Me një kontribut të jashtëzakonshëm veprimtarishe në Belgjikë e më gjërë, Shoqata “Nënë Tereza”, zë një vend të rëndësishëm jo vetëm në bashkësinë shqiptare të Belgjikës, por edhe në mardhëniet me institucionet belge, kryesisht ato të Namurit, me të cilat prej vitesh kanë krijuar një frymë bashkëpunimi, duke u bërë edhe urë lidhëse me institucionet homologe shqiptare e Kosovare.

Atë ditë, që në Namur të Belgjikës po flitej shqip, mbi qiellin e Europës po fluturonte simboli i letërsisë dhe i kulturës shqiptare, At Gjergj Fishta, një ndër katër avionët e Flotës Ajrore Shqiptare ishte pagëzuar me emrin e këtij poeti të madh.

Kush ishin ato që organizonin këtë veprimtari kaq madhështor?

Adnan Rexhepi, President i Shoqatës “Nënë Tereza” në Namur dhe Arian Bajraktari, drejtor i Shkollës Shqipe “Faik Konica”.

Po kush ishin ato shqiptarë me zemër të madhe që kishin udhëtuar në hapsirat qiellore të ëndrrave të Fishtës për të ardhur në këtë takim kaq domethënës?

Ata ishin figura të shquara, përfaqësues të kulturës dhe religjioneve fetare si: Don Dr. Mikel Sopi, Famullitar në Ferizaj - Kosovë, Hoxhë Avni Dobra, studiuesi dhe hulumtuesi i Fishtës Frano Kulli dhe historiani Ndue Bacaj.

Aty shpalosen aftësitë e tyre, patosin kombëtar, artistët Mirush Kabashi “Nderi i Kombit” dhe Anila Dervishi me vargjet epike të Fishtës, lahutarët rapsodë Pretash Nilaj “Mjeshtër i Madh” dhe Xhavit Balidemaj, si dhe harpistja Bujana Ameti, etnografia Rita Shkurtaç, Kryetare e Shoqatës kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, me veshje të demonstruara nga Deart Bajraktari, Anxhela Shkurtaç dhe Denajda Bajraktari, të cilët si një trupë profesioniste dhuruan emocione të jashtëzakonshme, duke elektrizuar një sallë të tejmbushur.

Organizatorët dhe pjesëmarrësit e këtij simpoziumi e kthyen këtë takim historik në një festë të madhe, falë edhe moderatoreve Linda Kavaja dhe Saranda Rexhepi, të cilat vranësirën e qiellit belge e zbutën me rrezet e ngrohta që Fishta në udhëtimin e tij ajror përcillte nga Shqipëria.

Vogëlushët e Shkollës “Faik Konica” - Namur me mësuesit Muhamed Bekteshi, Annie Celami, Elsa Haskurti, Donald Miftaraj Noka, e pasuruan këtë veprimtari me cicërimat e tyre.

Fjalën e rastit për hapjen e tij e mbajti z.



Adnan Rexhepi, me cilësinë e Presidentit të Shoqatës “Nënë Tereza”, organizator i kësaj veprimtarie.

Ishin çaste emocionuese, që në një vend mik u bashkuan tingujt e Himneve tona Kombëtare dhe të pranishmit me dorë në zemër u përulën para vogëlusheve

të Shkollës Shqipe “Faik Konica” që interpretuan të veshur me uniformën kuq e zi.

Gjatë simpoziumit, morën pjesë dhe përshëndetën Kryetari i Bashkisë Namurit z. Maxime Prevot, si dhe Kryetari i Bashkisë Lezhë z. Pjerin Ndreu.

Me shumë dashuri dhe krenari veprim-

tarine e përshëndetën edhe diplomatët Viola Kaloshi dhe Miftar Kryeziu.

“Ne jemi një vend i vogël, por me histori të madhe” u shpreh në ligjeratën e tij z. Arian Bajraktari, Drejtori i Shkollës Shqipe “Faik Konica”, por në këtë veprimtari organizator dhe kordinator, i cili foli për rëndësinë e këtij simpoziumi, duke treguar se kudo që të jemi, kemi për detyrë të bëhemi propogandues, përcues, mbrojtës dhe trashëgues të vlerave tona kombëtare.

Diaspora, meveprimtarine e saj, me shoqatat, me mediat, me veprimtarite kulturore, artistike, shkencore e sportive, është siç mund ta quajmë Ambasada e in-



teresave tona kombëtare.

Kjo veprimtari u ndoq me shumë interes nga mediat lokale belge dhe ato shqiptare. Nga Shqipëria bashkë me ne udhëtoi edhe gazetari i mirënjohur, malësori i “thekur” Tom Therçaj, përfaqësues i Radio Televizionit Shqiptar, i cili referatin e tij në këtë simpozium e solli përmes kameres së tij, me një dokumentar brilant kushtuar figurës madhështore të letërsisë dhe historisë shqiptare At Gjergj Fishta.

Shkuam atje me aq dëshirë për të pasqyruar këtë veprimtari në mediat tona ku kontribuojmë, Linda Kavaja dhe Maison Kavaja në TV1 Channel - Shkodër dhe unë në median e shkruar, por edhe në Televizionin “Kultura Shqiptare” në SHBA.

Në fund, organizatorët shpërndanë mirënjohje dhe certifikata pjesëmarrje në emër të shoqatës “Nënë Tereza” në Namur të Belgjikës.

Mbresat tona janë të jashtëzakonshme, pasi udhëtua drejt një vendi që Bota e njeh si “Benelux”, por luksin e vërtetë e gjetëm mes bashkëatdhetarëve tanë, të cilët kishin ulur nga qielli “Qiellorin” At Gjergj Fishta.

**Ramazan Çeka dhe Zef Nika,**  
Prill 2023



# Kryeredaktori i gazetës “Dukagjini” dhe publicisti i njohur, Prele Milani, fitues i Çmimit “Hamit Boriçi”, edicioni i 6-të

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dega Qarku Shkodër, zhvilloi këto ditë edicionin e gjashtë të ndarjes së çmimeve vjetore “Hamit Boriçi” për gazetarët e qarkut Shkodër. Një aktivitet ky tashmë i shndërruar në tradicional për gazetarët e qarkut Shkodër, i cili mban emrin e një prej figurave më të rëndësishme të gazetarisë shqiptare, Hamit Boriçi.

Prof. Dr. Hamit Boriçi, i cili njihet si themeluesi i degës së gazetarisë shqiptare në Universitetin e Tiranës, si dhe botues i shumë librave për gazetarinë, sot në moshën 94 vjeçare ishte i pranishëm në sallën e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, së bashku me kreun e UGSH, gazetarin e njohur Aleksandër Çipa, kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shkodrës, Zija Vukaj, si dhe gazetarë të qyteteve të qarkut Shkodër, si dhe të ftuar nga institucionet e qarkut, profesorë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, shkrimtarë dhe personalitete publike.

Aktivitetin në fjalë e ka nderuar edhe Kryetarja e Këshillit Bashkia dhe njëherazi, Drejtore Rajonale e Arsimit Shkodër, Brisela Kadaja.

Takimi në fjalë është hapur dhe monitoruar nga Kryetari i Unionit të Gazetarëve të Shkodrës Gaspër Marku, i cili pas përshëndetjes së rastit, ftoi Kryetarin e UGSH-së në qendër, Aleksandër Çipa, profesor Hamit Boriçin dhe shkrimtarin Zija Vukaj, për të përshëndetur aktivitetin.

Më pas, ka ardhur moment më emocionues, kur kreu i UGSH-së dega Shkodër, Gaspër Marku, shpalli fituesit e çmimeve “Hamit Boriçi” për vitin 2023, edicioni i gjashtë.

Mes 6 fituesve, spikat emri i Prele Milanit, gazetarit të njohur me një karrierë të gjatë në disa organe shtypi, prej shumë vitesh në cilësinë e Kryeredaktorit të gazetës “Dukagjini”, botues i shumë librave me tematika të ndryshme, historike, patriotike, artistike, e të tjera. Por, njëherazi, edhe një veprimtar shumë i spikatur, sidomos në mbrojtje të interesave dhe të zhvillimit të zonës së Dukagjinit.

“Kryeredaktori i parë i gazetës “Dukagjini” duke vijuar 5-6 vite, dhe deri më sot me rreth 352 artikuj në këtë gazetë. I spikatur në evokimin e vlerave historike, kulturore e etnografike dhe pasqyrimin e tyre në shtypin e shkruar. Trajtues shumë kompetent i problematikave bashkëkohore në rrafshin e gjithanshëm të shoqërisë sonë”, ishte motivacioni që shoqëroi dekorimin e publicistit, Prele Milani

Ndërkohë, pesë fituesit e tjerë të Çmimit “Hamit Boriçi”, edicioni i gjashtë, janë këto:

## 1-Nereida Vitoja

E diplomuar për gazetari në Univer-



sitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, e nisi karrierën në “Star Plus Tv” rreth 5 vite më parë. Gjatë kësaj periudhe ajo ka mbuluar ngjarjet jo vetëm nga qyteti i Shkodrës, por edhe tërmetin e vitit 2019 në Thumanë në transmetim maratonë. Në vitin 2020 u bë një zë i fuqishëm, përmes raportimeve direkte, duke përcjellë zhvillimet e fundit tek qytetarët e izoluar gjatë periudhës së pandemisë. Në vitin 2021, iu

besua roli i redaktore në gazetën “Scodrion”. Nereida ende vijon me të njëjtin përkushtim punën për të qenë një burim i drejtpërdrejtë dhe i pavarur informacioni për qytetarët shkodranë

## 2-Maison Kavaja

Vlerësohet për një kontribut mbi 20 vjeçar në mediat lokale edhe atë kombëtare, si TV “Rozafa”, Top Channel, e të tjera. Në fushën e video & fotografisë, realizues i shumë dokumentarëve dhe video xhirimeve që promovojnë Shkodrën dhe Shqipërinë. Pjesë e aktivitetit të tij janë edhe Keit video Marketing dhe Medikus Menager Marketing.

## 3-Marjo Gjini

Gazetar, drejtues dhe realizues i emisioneve të ndryshme televizive dhe radiofonike, reportazheve dhe promovues i vlerave, traditave dhe bukurive natyrore të Shkodrës, me aftësi të spikatura profesionale në rrugëtimin e tij mediatik të nisur në TV “Rozafa” dhe që vazhdon në RTSH.

## 4-Admir Uruçi

Gazetar dhe komentator sportiv, me një karrierë rreth 20 vjeçare. Pasues i traditës së mirëfillte të ish gazetarit të mirënjohur shkodran, Rifat Uruçi, duke spikatur në pasqyrimin e vlerave sportive të qytetit të Shkodrës, si dhe ato të Tiranës. Karrierën më të pasur e ka në shtypin e shkruar, si korrespondent i Shkodrës për gazetën sportive, “Panorama Sport”.

## 5-Dashamir Dini-Çmimi i Karrierës

Me një karrierë dhe përvojë të gjatë mediatike. Gazetar në Radio Shkodra dhe RTSH. Realizues me profesionalizëm i kronikave të shumta në terren, si dhe drejtues i emisioneve radiofonike dhe televizive. Po kaq i spikatur edhe në rolet drejtuese, kryeredaktor, si dhe drejtor i RTSH Shkodra.

## Gac Marku

kryetari i Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë, dega Shkodër





# Federata e Paqes Universale në Shqipëri, në Shkodër

Federata Universale e Paqes (UPF), një rrjet ndërkombëtar dhe ndërfaqësor i individëve dhe organizatave, duke përfshirë përfaqësues nga feja, qeveria, shoqëria civile dhe sektori privat, i është përkushtuar arritjes së paqes botërore. Një OJQ në status të përgjithshëm konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara, UPF mbështet punën e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht në fushat e ndërtimit të paqes ndërfaqëse, edukimit për paqen dhe forcimit të martesës dhe familjes.

Federata Universale e Paqes, është një rrjet global individësh dhe organizatash të dedikuara për ndërtimin e një bote paqeje në të cilën të gjithë mund të jetojnë në liri, harmoni, bashkëpunim dhe prosperitet. Paqja nuk është thjesht mungesa e luftës ose një term që vlen vetëm për marrëdhëniet midis kombeve. Paqja është një cilësi thelbësore që duhet të karakterizojë të gjitha marrëdhëniet.

Më 30 tetor 2005, në sallën e Pallatit të Kongreseve me pjesëmarrjen e 3000 personave nga e gjithë Shqipëria u zhvillua veprimtaria inaugurues i Federatës së Paqes

Gjatë këtyre viteve janë organizuar mbi 700 aktivitete të ndryshme në të gjithë vendin në mbështetje të Ditëve Ndërkombëtare të OKB-së, si Dita Ndërkombëtare e Familjes, Dita e Rinisë, Dita Globale e Prindërve, Dita Ndërkombëtare e Paqes, Dita Ndërkombëtare e Librit, Java Ndërkombëtare e Harmonisë Ndërfaqëse, Dita Ndërkombëtare e Gruas etj. Rreth 35.000 persona në gjithë vendin janë bërë pjesë e këtyre aktiviteteve kombëtare & lokale ku 5200 prej tyre kanë marrë titullin Ambasador për Paqe për kontribute të veçanta në punën e tyre.

Më datë 12 prill 2023, Këshilli i Paqes Shkodër organizoi konferencën me temë 'Paqja fillon nga shërbimi për të tjerët', në ambientet e Hotel "Colosseo", ku morën pjesë rreth 90 përfaqësues të shoqërisë civile, Ambasadorë për Paqes, miq dhe

të ftuar të tjerë. Të jetuarit për hir të të tjerëve është motoja udhëheqëse e Federatës së Paqes Universale dhe e Ambasadorëve për Paqe.

Veprimtaria u moderua nga z. Arnold Grami, koordinator i Federatës së Familjes - Shkodër. Fjalën përshëndetëse në emër të Këshillit Drejtues e mbajti z. Ali Laçaj, koordinator i Këshillit Shqiptar të Paqes, i cili ndër të tjera vlerësoi punën e bërë nga Këshilli i Paqes Shkodër gjatë 4 viteve të fundit. Kryetarja e Këshillit të Paqes Shkodër znj. Marie Koliqi, paraqiti një përmbledhje të veprimtarive kryesore të zhvilluara në Shkodër. Më pas z. Gani Rroshi, Sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Paqes Shqipëri, bëri një prezantim të parimeve dhe veprimtarisë së Federatës së Paqes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë ishte vlerësimi i 10 figurave të nderuara të jetës publike si gazetarë, mësues, punonjës socialë dhe drejtues të institucioneve publike, me titullin Ambasador për Paqe (z. Ndue Sanaj, znj. Merita Sokoli Çoba, znj. Rezarta Pode, z. Alfred Muharemi, z. Sabail Gjyli, znj. Marjana Molec, znj. Vitore Prroni, z. Astrit Dervishi, znj.

Elmira Nehani dhe Ergys Ivziku).

Në fund të kësaj veprimtarie kaq të bukur, Asambleja e Ambasadorëve për Paqe Shkodër bëri edhe zgjedhjet për kryesinë e re që do të drejtojë Këshillin e Paqes Shkodër për 4 vitet në vazhdim. Pas propozimeve të bëra, kryetare e Këshillit të Paqes Shkodër u zgjodh znj. Majlinda Laçaj dhe nënkryetarë z. Muhamet Kaçirani dhe znj. Ledi Bilali.

Znj. Majlinda Laçaj ka mbaruar studimet në master shkencor në menaxhim Turizmi të qëndrueshëm në universitetin Luigj Gurakuqi. Çertifikuar nga ISSAT Institute për "Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci"

Për momentin po kryen specializimin e liderit në Universitetin e Harrisburgut të Shkencës dhe teknologjisë. Ka marrë pjesë në trajnime të shumta të akademisë Elita, tek ACT Center, në Institutin e Edukimit të Trashëgimisë dhe Turizmit. Këto kanë qenë trajnime në fushën e liderit, politikës, kulturës, financave dhe ligjit. Tashmë ajo është specialist e liderit në Universitetin e Harrisburgut, Merr pjesë në panelin e Diskutimit të grave WomanTech, për teknologjinë, shkencën dhe inovacionin ku është edhe ambasadore globale. Ka qenë drejtore e rajonale e Trashëgimisë kulturore Shkodër dhe po ashtu drejtore ekzekutive në shumë pozicione të organizatave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Federata e Paqes Universale në Shqipëri, përgjatë 15 viteve të veprimtarisë së saj në vend, ka bërë pjesë të saj mbi 5000 Ambasadorë për Paqe ndër shqiptarë, të cilët i përkasin të gjitha fushave të jetës.

Redaksia e gazetës



Majlinda Laçaj, Kryetare e Federatës së Paqes Universale, dega Shkodër





# Udhëtim në Kinë pas covid-it

Jeta pas covid -9, na ka ndryshuar të gjithëve, në mënyrën e konceptimit të jetës, në maturinë me të cilën bëjmë shpenzime të caktuara, por mbi të gjitha në frikën e shëndetit.

Ndërsa nga udhëtimi i fundit në Kinë kuptova që gjërat ishin pak më ndryshe, atje njerëzit ishin bërë më të ndërgjegjshëm, por jo me frike siç është përgjithësisht në Evropë. Në fillim mbërritja, kontrollet e sigurisë ishin shtuar, por gjithçka ishte rutinë, asgjë specifike. Kur mbërrita në qytetin, ku duhej të zhvilloja veprimtarinë, për të cilin kisha shkuar, polici në stacion (pasi për shkak të sistemit atje duhet udhëtosh me pasaportë

perëndimi edhe pse është nga qytetet industriale, që furnizon të gjithë botën në sektorin përkatës të tekstilit, kësaj here kishte ndryshuar. Pastërtia në rrugë ishte më e dukshme. Kishin pranuar marka

dhe shije të forta pothuajse të pamundura për tu ngrënë nga dikush që nuk është mësuar. E megjithatë, kishte hapësira të vendit ku çdo gjë kishte mbetur akoma e paprekur dhe tipike për të mos harruar

kishte ndryshuar, nëse më përpara kishin frikë nga konkurrenca e tregut, pranonin çdo ndërhyrje në lidhje me marrëdhëniet ekonomike të biznesit kësaj here ishte diçka tjetër. Duke qenë se periudha e covidit s'pостоi nga tregu të gjitha bizneset e sektorit që u gjeten të papërgatitur, në treg kishte mbetur vetëm 'elita' siç e quatin ata dhe sipas tyre ata që janë tani në treg janë vetëm ata që dinë të bëjnë biznes jo kushdo siç ndodhte më përpara, çka e bënte më sfiduese kërkesat tona për rritje të ofrimit të shërbimit dhe produktit përfundimtar, nëse më përpara mund të bëjë ndërhyrje të vogla pa kosto shtesë, tani përgjigja e pare ishte "edhe pse një ndërhyrje shumë e vogël, ka kosto shtesë". Ky vetëbesim nuk ishte vetëm tek drejtuesit, por edhe te stafi nëse më përpara një nga komplimentet që kam bërë gjithmonë për popullin e tyre ishte se nuk thonë kurrë jo, tani mendohen më shumë. E për gjithë situatën një nga vizitorët ndërkombëtarë që ishte i pranishëm në ditët e fundit të qëndrimit tim atje tha sikur e ndjejnë veten se janë bërë zot të kësaj bote me qëndrimet, që mbajnë kësaj here.

Por gjatë qëndrimit pata fat të shoh një nga festimet më të rëndësishme që bëjnë në një vit, ditën e shpirtrave që kanë ndërruar jetë, siç thuhet tek ne Dita e Shumve.

I gjithë festivali zgjaste tre ditë dhe paradat ishin në të gjithë qytetin ku ishin të përfshirë të gjitha moshat, sektorët e punës publike dhe private. I gjithë ky festim bëhej, sepse sipas tyre jeta e përditshme është më e mirë se kjo në tokë, e prandaj shërbente si një ditë festimesh dhe jo vetëm. Në këtë ditë të gjitha vajzat dhe djemtë që merrnin pjesë në një prej paradave ishin beqare dhe kjo ditë shërbente si një ditë për të parë njeri-tjetrin dhe për tu njohur pasi mendohej se, nëse njihen në këtë ditë kanë bekimin e paraardhësve të tyre që nuk jetojnë. Ata njihen nga veshjet tipike të paradës (foto ilustruese).

Në përmbyllje të këtij udhëtimi mësova se pavarësisht nga vështirësitë personale që mund të kenë një person, por edhe nga covidit që kryqëzoi botën e rëndësishme pas saj është të përmirësojmë veten dhe të përpiqemi të përmirësojmë edhe komunitetin që na rrethon.

**Klodjana Serraj**



edhe nëpërmjet qyteteve) më tha "Qe nga covidit jeni personi i pare i huaj që vjen në qytetin tonë, duke më dhënë një mikpritje më të ngrohtë nga ajo përpara covid-t".

Mbërritja në një qytet tipik kinez, zonë industriale, që përpara covidit ofronte vetëm ushqimi vendas, asnjë ndërhyrje

ndërkombëtare si Mc Donald and KFC (te dyja rrjete ushqimi të shpejta, të shërbyer në çast), madje kishin modifikuar edhe recetat e tyre, duke hequr erëza me aroma

autenticitetin.

Por një nga gjërat që më ka bërë më shumë përshtypje gjatë këtij udhëtimi më ka bërë mendësia e njerëzve, që atje





# Doli nga botimi libri me titull “Urtësi dukagjinase”, që përmban fjalët e urta dhe frazeologjite në Trevën e Dukagjinit, me autor Voc Deda

**Shkrimtari, studiuesi e publicist Voc Deda nuk ndalet në zbulimin e publikimin e urtësive dukagjinase. Për këtë punë të jashtëzakonshme, ja çfarë shkruan redaktori i librit, Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Shkodrës, Shkrimtari, Historiani, Studiuesi dhe Përkthyesi, Zija Vukaj.**



Pas një rrugëtimi të gjatë e të suksesshëm, që kurorëzohet me njëzet libra, autori Voc Deda shfaqet para lexuesit me këtë vëllim të vyer dhe mjaft interesant, ndërtaur mbi proverbat ose fjalët e urta. Në opusin krijues të një autori ky lloj libri vjen pas përvojash të gjata të jetës dhe të shkrimeve. Vepra të tilla janë produkte të meditimeve të gjata e të mprehta, janë kontakte njohjesh të thella me trashëgiminë dhe etno- kulturën kombëtare; janë gjithashtu edhe kontakte me kulturat e tjera përmes leximesh e vëzhgimesh të ndryshme, por mbi të gjitha janë frymëzuar nga intuita e një njeriu të zgjuar, për ta drejtuar vëmendjen tek mençuria që brezat njerëzorë ia kanë kaluar njëritjetrit. Proverbat janë rruga më e vjetër përmes së cilës është përcjellë brez pas brezi dija dhe urtësia dhe një nga rrugët më të shpejta nëpërmjet së cilës ne mund të nxisim vetveten dhe të tjerët në një ndryshim në mënyrën e perceptimit të problemeve dhe të reagimit ndaj tyre. Shumë prej fjalëve të urta kanë arritur ta kondensojnë mendimin në fraza të shkurtra, të gdhendura, plot lakime, që siç thotë Volteri “hyjnë në shpirt, si drita në sy, me kënaqësi e pa mundim. Ato janë si një xham që mbron objektet, por në të njëjtën kohë i lë të duket”.

Siç dihet, proverbat ose fjalët e urta e shprehin mendimin në forma të ndryshme: si përfundime logjike, si parime, si ligje, si këshilla. Sintetizmi, është karakteri përgjithësues, mënyra figurative e disa herë e tërthortë e shprehjes. Mbledhja e ruajtja e kësaj trashëgimie, si dhe paraqitja brenda këtij vëllimi, përbën një kontribut të madh që autori ua kushton lexuesve të sotëm e të nesërm; nga ana tjetër, ky libër përbën një stacion të rëndësishëm në ruan-

jtjen e vazhdimësisë së traditës së mbledhjes së fjalëve të urta që i ka fillimet qysh në letërsinë e vjetër shqipe, konkretisht në shekullin XVII me Frang Bardhin (1635) te Fjalori latinisht- shqip, për të vazhduar me De Radën, Th. Mitkon, S. Dinen etj.


Para së gjithash, kur marrim në dorë këtë libër dhe fillojmë të udhëtojmë në faqet e tij, secili nga ne impresionohet nga fondi i gjerë i materialit me të cilin ka operuar autori dhe natyrshëm lindin disa kureshtje që mund shprehen në formë pyetjesh: Si është e mundur të posedohet gjithë ky material i mençurisë së brezave në memorjen e një individi? Si janë mbledhur e ruajtur gjithë këto visare, që ngjajnë si fosile gjuhësore, letrare, filozofike, psikologjike etj? Si shpjegohen kontaktet e autorit me fjalët e urta të popujve të tjerë e kështu me radhë? Për t'u dhënë përgjigje disa prej kureshtive tona në lidhje me këtë libër, mendojmë se na ndihmon vetë kompozicioni, pra mënyra si është ndërtaur ngrehina e veprës.

Në aspektin e kompozimit të këtij libri autori Voc Deda ka përdorur një strukturë mjaft të studiuar dhe efikase. Gjithë visarin e madh të fjalëve të urta e ka shtrirë në dhjetë kapituj. Vetë dhjeta, si numri i plotësisë dhe i përsosmërisë, sipas simbolgjisës së numrave që vjen qysh nga lashtësia, e ka ndihmuar me magjinë e vet simbolike që të hedhë një vështrim thujse të plotë mbi të gjitha fushat e jetës, që kanë të bëjnë me çdo gjë që thith dhe pasqyron ontologjia dhe intelektin njerëzor. Në kapitullin e parë autori ka vendosur proverba që kanë të bëjnë me: personalitetin, karakterin, dinjitetin, zgjuarsinë, miqësinë, mikpritjen, besën, guximin, atdheun, patriotizmin, lirinë etj. Gjejmë brenda këtij kapitulli apo bllokut proverba të tilla si: “Burri nuk matet me pëllëmbë, por me zemër e vepra.”; “Ma zi me t'u mat, se sa me të ra.” “Mos u ban mjaltë, që të të hanë mizat.” e shumë të tjera, që me përqendrimin e lartë kuptimor qartësojnë realitetet të përjetshme.

Në kapitullin e dytë autori ka vendosur blloqe proverbash dhe frazeologjish me nëntituj të tillë si “Drejtësia dhe ndershmëria”; “E vërteta dhe sinqeriteti”; “Aftësia dhe mençuria”; “Mirësia dhe mirënjohja”; puna dhe qëndrimi ndaj saj etj. Për çdo nëntitull autori ka vendosur proverba shqiptare dhe të huaja, të mbledhura nga

të gjitha kulturat shpirtërore të botës.

Kapitulli i tretë, që përmban momentet e jetës së përditshme të njeriut me të vërtetat e botës së brendshme të individit, si kujdesin, kursimin, diturinë, përvojën, edukatën, traditën, ndjenjat, estetikën etj., paraqitet mjaft i pasur e i punuar me kujdes.



Në kapitullin e katërt proverbat dhe frazeologjitë u kushtohen nocioneve të tilla si kolektivi dhe udhëheqësi, rregullsia dhe zhvillimi, rinia dhe pleqëria, familja dhe fisi, marrëdhëniet njerëzore etj. Një bllok i veçantë i këtij kapitulli përbëhet nga proverbat dhe frazeologjitë për motin: Marsi lik e prilli rip. Gusht e gunë. Shëngjergji plak e nxjerr verën me dajak. Kur të hijsh në prill hiq një fill. Në maj qiti në diell e thaj, veni në arkë e mos i baj. Prill- maj mos u ndaj. Kur të bëhet gjithi i fikut sa kamba e patës, ia don qejfi edhe plakës. Moti i mirë sytë çilë. Në korrik pëlçet pula në furrik. Shiu i butë lag të marrë e të urtë. Këto proverba të kompozuar në vargje janë mjaft interesante. Ato rimojnë si dy vargje apo si dy hemistikë (gjysmëvargje) brenda një vargu. Rima, si element i fuqishëm memorizues, i bën të mbahen mend përjetësisht nga çdo individ. Por lojërat e fjalëve, rimat e pjeshme ose të plota, kalamburet dhe nëntekstet

i gjejmë edhe në kapitujt e pestë dhe të gjashtë. Kemi konkretisht: Druni i mirë duket nga hini. Druni i keq duket nga tymi. Lopa e mirë duket nga gini. Njeriu vlerësohet nga mendimi. Hajduti vjedh fiqtë. Spiuni shet miqtë.

Në kapitujt e shtatë dhe të tetë, krahas pasurisë së proverbave dhe larmisë së tematikave vërejmë formën e tyre që ngjan me reflektime në formë sentencash të ngjeshura ku shpesh rimat nuk paraqiten të nevojshme.

Interesant është procedimi i autorit Voc Deda në kapitullin e nëntë. Mes të tjerash autori ka proceduar me frazeologji dhe idioma që kanë të bëjnë me organet e shqisave të njeriut, por edhe për burrin, për gruan, për shtëpinë, për trimërinë etj. Natyrisht që kjo mbledhje dhe ky sistemim kanë kërkuar punë të gjatë e këmbëngulëse. Disa frazeologji në këtë kapitull ngjajnë me gjuhën e zhargoneve dhe të argove. Pra shpesh janë kaq alegorike, sa kërkojnë vëmendje dhe shpjegime. Ky lloj kriptologjierimi (ligjërim i fshehtë) ka brenda vetes edhe ngjyresa të shumta komike, që burojnë nga paradokset e jetës, që gjenia e popullit i ka kalçifikuar në mënyrë precize. T'a kishin ba rub. T'a paça. Tash mbushet helli. Të ba flamë. Të tanë e bani pikë- pikë. Të vret e të la priedat. Të late helmin. Të han bostanin e të rreh me lëkurë. Të nep dushk për gogla. Të ban namin e të qet për hell.

Të kam ra mbrendë. Të pin' ufull. Të ka hukatë në gojë. Të shet e të blen. Të hjek priedat nën kambë.

Librin e mbyll kapitulli i dhjetë, ku autori sjell disa informacione të vjera rreth lashtësisë dhe fuqisë shprehëse të gjuhës sonë amtare, si dhe pasuron argumentin me situata të ndryshme ligjërimi, duke shënuar edhe rolin e individëve të shquar shqiptarë dhe të huaj që janë marrë me studimin e gjuhës dhe etno- kulturës shqiptare.

Përfundimisht, dalja e këtij libri përbën një event të rëndësishëm jo vetëm në rrugëtimin intelektual të autorit Voc Deda, por për gjithë kulturën dhe gjuhën tonë, pasi kthehet në një aleat të çdo studiuesi që merret me çështjet e gjuhës, të mençurisë dhe të gjithë trashëgimisë sonë kulturore dhe shpirtërore.

Shkodër, Qershor 2022



# Poeti Luigj Temali u nda nga jeta

## Fjalë në ceremoninë mortore të poetit Luigj Temali

Për ju Albana e Irma, vajzat e Luigjit!  
Për ju Vitore, motra e Luigjit!  
Për ju Gjovalin, Rrok, Mark e Zeke, vëllezërit e Luigjit!  
Për ju të afërm të Luigjit!  
Për ju miq e shokë të Luigjit!  
Për ju pjesëmarrës në këtë ceremoninë mortore të Luigjit!

Sot jemi mbledhur për ti dhënë lamtumirën e fundit poetit, shkrimtarit dhe anëtarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Luigj Temalit!

### Kush ishte Luigj Temali?

Luigj Temali lindi me 23 Janar 1941 në Shkodër, fëmija i parë i Zef Temalit dhe Marije Ndrekes. i ati, Zef Temali i lindur në Shkodër, ishte me prejardhje nga fshati Telum i krahinës Temal, ndërsa nëna nga Pulti.

Luigji kreu shkollën 7 vjeçare në shkollën 'Ndoc Mazi' në vitet 1948-1955, ndërsa shkollën e mesme në gjimnazin "28-29 Nëntori" në vitet 1956-1958.

Pasi mbaroi shkollën e mesme ai kreu detyrën e shërbimit ushtarak, në detyrën e shoferit të gatishmërisë së Repartit ushtarak 1105, në vitet 1961-1962.

Më vonë punoi punëtor në ndërmarrjet Nil-Prodhome, fabrika e Tullave, Ndërmarrja komunale banesa, Kooperativa Artizanat-Veshmbathje. në vitet 1963-1966.

Luigji student i Fakultetit Ekonomik në Universitetin Shtetëror të Tiranës, dega Financë, në vitet 1966-1970. Në vitet 1973-1975 përfundoi studimet e larta në degën e filozofisë.

Mbas studimeve të larta punoi ekonomist financiar në Ndërmarrje Peshkimit, Kombinati i Drurit, janar 1973-1975. Më pas financier në Ministrinë e Financave në vitet 1970-1972.

Ka ushtruar detyrën e shefit të llogarisë për 25 vjet në Telekom Shqiptar, Shkodër në vitet 1976-2001.

Luigji, me Marijen krijuan familjen dhe patën dy fëmijë, dy vajza, Albanën e Irmën.

Luigji ishte një bashkëshort dhe baba i shkëlqyer, ishte një bashkëpunues me shoqërinë e tij i papërtuar!

Luigji ka qene anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", mjaft aktivist i saj dhe ajo e ka nderuar me tituj nderi dhe mbi të gjitha me "Mirënjohjen Martin Camaj", për krijimtarinë e tij të suksesshme,

Më 1997 botoi librin e parë 'Për ty', ku përfshihet dhe poezia "Flamuri Ynë" si propozim për himn të ri me muzikë të Ferdinand Lleshit. Më tej krijimtaria e Luigjit vazhdon me librat :

Një dritare nga jeta - 1998,

Gjurma -2001

Lule nën një shkëmb 2001

Buzëqeshja e Yjeve- 2010

Veprimtaria e tij letrare përfshin më shumë se 350 artikuj të botuar në gazeta dhe revista të ndryshme si "Drita", "Telegraf", "Shqipëria Etnike", "Sot", "Dukagjini", revista "Muzgu" dhe revista "Fjala" (Koplik),

Luigj Temali gjithë jetën e tij, u shqua për punë të palodhur në shërbim të njerëzve, në shërbim të kolektivit e familjes, në punën e tij krijuese e aktivist i palodhur i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Luigj Temali u nda nga kjo jete për të len të gjallë krijimtarinë e tij të pavdekshme!

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe në emrin tim, ju shpreh ngushëllimet vajzave, vëllezërve e motrës, të afërmeve, kolegeve dhe miqësisë!

Ju paste lanë jetën, mbarësinë e mirësinë në jetën tuaj! I lehtë të qoftë dhe poetit Luigj Temali!

I paharruar vepra e poetit Luigj Temali!  
Lamtumire poeti Luigj Temali!

Ne, që të harruam sot me mos përfillje do të marrim të njëjtin çmim ditën e lamtumirës sonë të madhe. Vdiqe i vetmuar dhe i uritur nga dëshira për shkrim, këndim, dituri dhe kulturë. Duke mos qenë moshatare, të njoha vonë, por atëherë kur kishe vizatuar portretin, që meriton një njeri i nderuar. Ekonominë dhe poezinë i kishe ne gjak. Të gufojnë nga gjoksi vegime të tilla fluturake djaloshare në një moshë të tillë sa me shkri akujt e acartë pleqërisë është fat.

Lexoje e recitoje e me pasion dhe përmes bukurive vargëtarë poetike kaloje në një botë tjetër teje djaloshare i rrethuar prej muzave ndonëse veshur me kostumin

redaktuar e publikuar në faqet e gazetës shkrimet e poezitë e para të tij. Ishte siç e përshkruani ju. Ekonomist i Zoti, letrar i pasionuar, familjar i mirë, shok e mik besnik.

Ngushëllime familjes!

Pushoftë në paqe i miri Luigj Temali.

**Roza Mhill Pjetri:** Jeta është e bukur dhe e pasosun. Luigji ndërroj jetë e kjo na trishtoj, sepse nuk do e kemi më fizikisht në mesin tonë. Ai vazhdon ecjen e tij drejt Parajsës, duke na lehtësuar dhimbjen me kujtimet e bukura që ne kemi për Luigjin tonë. Ecja e tij e lehte bashkohej me vargjet plot aromë mirësi e lavdie. Në veprimtaritë tona, me Shoqatën Atdhetarë



## DISA OPIONE

**Prele Milani,** shkrimtari, poeti, historian e publicist, shkruan:

LUIGJ TEMALI PUSHOFSH NË NEN TINGUJT E KËNGËS SË SHËLBIMIT!

Jeta e plakut është si nata e dimrit, vjen me kthjellim e hënë dhe agon me borë e ngrica të tmerrshme.

Dje mora vesh se miku im Luigj Temali nuk e kapi trenin e Shën Gjergjit të sivjetme.

Sot u zhdruk nga mesi ynë një tjetër kumbarë i jetës kulturore të qyteti tonë. Pak kush, së paku mediadikisht u kujtua të fliste dy fjalë mirënjohje për stekën e vjetër të ekonomistëve të qytetit, për adhuruesin zemër flaktë të Shkodrës, Dukagjinit dhe letërsisë. Koha është peshorja më rreptë dhe e drejtë e vetmja drejtësi stoike mbi këtë botën të pa drejtë.

dhe republikën e plakut qefanik. Në këtë aspekt ju ishit krejt i veçante.

Luigj Temali kishte zejen e publicistikes, dhe e kure lypte nevoja polemizonte me theksime ëndërrimtare. Ishe zemër bardhë, punëtorë i zellshëm, natyre e bute dhe e thjeshtë. Shqipëria ishte hyj i idealit tënd shëlbues.

Luigj Temali pushofsh në paqe nën tingujt e këngës së shëlbimit!

**Ndue Sanaj:** Prelë shkruan me shumë pasion për Luigjin tonë dhe me të drejtë, Luigji ishte Ai, që ju shkruani për te!

Sot u përcuall për në banesën e fundit me shumë dinjitet nga familja, të afërt, nga shoqëria e përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me kunorë e fjalë mortore!

Ju paçi jetën e gjatë dhe Luigji pushoftë në paqe!

**Ndue Lazri:** Sa keq po më vjen. E kam pasur shumë shok gjatë viteve që kam punuar në gazete në Shkodër. Kam

"Dukagjini", vargjet e Luigjit i kishim qershia mbi tortë. Lumnosh në Parajsë me Krishtin i nderuam Luigj Temali dhe ngushëllime familjarëve.

**David Hasanaj:** E kam njohur dhe kam dëgjuar shumë për z. Luigj. Ju përcjell ngushëllime ju dhe vajzave të tij, Albanës, koleges time, që prej 15 viteve punuam së bashku.

Ngushëllime dhe Zoti ju forcoftë

**Zef Nika:** Prel, Zoti ta shpërbleftë për përkushtim që i ke kushtuar Luigj Temalit, i cili ishte një bashkëpunëtor i gazetës "Dukagjini".

Penda e tij mos humbët kurrë!

Pushoftë në lumnin qiellore!

Ngushëllime familjes dhe të afërmeve!

**Ndue Sanaj,**  
*Shkodër, me 21 prill 2023*



# Kush janë shqiptarët?

- Artikulli i të famshmes "National Geographic" -

Shqiptari është evropian: për më shumë se dy mijë vjet ka jetuar atje ku jeton tani – në fortesat e Epirit dhe Ilirisë, përtej Adriatikut paralel me thembrën e Italisë. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shqiptarët u përzier me fqinjët e tyre jugorë, grekët dhe ishin shtylla kurrizore e luftës për Pavarësinë e Greqisë. Bashkatdhetarët e Marko Boçarit emigruan të gjithë në Cefaloni, në brigjet e Greqisë, por afro 2 milionë shqiptarë më të pafate jetojnë tashmë nën sundimin turk. Sot shqiptarët, arabët, armenët, bullgarët, grekët, serbët dhe vetë turqit po vuajnë, siç ka ndodhur prej dekadash, nga plaga e sundimit turk. Nga këta popuj të pafat, shqiptarët janë të parët që duhet të tërheqin vëmendjen e një bote joegoiste. As rrahjet me thupra, as arma, as topi, as mërgimi, as burgimi, as edhe vetë vdekja nuk i tund nga vendi".

Folësi ishte një shqiptar i ri në moshë, që një pjesë të shkollës e kishte bërë në SHBA. Ai është rikthyer tani në vendin e tij, ku po punon me zell të madh për popullin e tij. Është një prej të paktëve njerëz të arsimuar në Shqipëri, por synon që brezi i ardhshëm të mos i numërojë me gishta burrat dhe gratë e arsimuara të Shqipërisë.

Fjalët e përmendura më sipër u paraprinë prej këtyre: "Për momentin, nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim të Shqipërisë, të gjithë klasat e njerëzve – myslimane dhe të krishterë qofshin – kanë një dëshirë, pothuajse një pasion për shkollimin kombëtar. Të gjithë ata e kuptojnë që, ashtu sikurse në të kaluarën shpata ishte simbol i fuqisë, sot shkollimi është perëndësia e fuqisë, dhe ata do të arsimohen, pavarësisht persekutimit".

Shqiptarët janë vetëdijues për nevojën që kanë për qytetërimin dhe progresin perëndimor. Por, që nga dita e parë e miratimit të Kushtetutës së re otomane, turqit e rinj ishin të vendosur që qytetërimi duhej të vinte tek shqiptarët, vetëm pasi të kishte kaluar në një sitë turke dhe muhamedanë. Ky program nuk mund të pranohej nga shqiptarët, edhe sikur turqit e rinj të kishin qenë në gjendje ta vinin në zbatim.

Gjatë 125 viteve para zbulimit të Amerikës, republika krenare e Venecias kishte një supremaci dashamirëse mbi qytetet shqiptarë të bregdetit, dhe kështu që e vonoi me një shekull dominimin turk. Me rënien e Skutarit në Shqipëri dhe dëbimin e venerianeve nga turqit në vitin 1478 / 79, këta të fundit filluan sundimin e tyre – shekuj të tërë mashtrimi, bese të thyer dhe mizorie. Rezultati i sundimit turk mund të përmblihet me zhytjen më thellë të shqiptarëve në varfëri, supersticion, dhe etje për gjak, për shkak të terrenit pjellor që garantonin historia malore dhe tiparet primitivë. Përgjatë dy mijëvjeçarëve, valët dhe impulsat e progresit nuk e kanë arritur shqiptarin, ose e kanë anashkaluar, duke e lënë të paprekur.

**Hakmarrja praktikohet ende**

Sot, ashtu si në të kaluarën, është e vërtetë që një në pesë malësorë flijohen prej hakmarrjes së tmerrshme, që vetëm qytetërimi mund ta çrrënjosë nga jeta e shqiptarit. Të qëllosh një person, edhe ti nëz, është çështje e marrjes së gjakut. Asgjë tjetër nuk mund ta kthejë nderin e plagosur. Nëse nuk vritet vetë vrasësi, atëherë një prej të afërmeve duhet të jetë viktimë, e kështu nis zinxhiri i pafund. Kur hakmarrja ka shkuar shumë larg, mund të blihet nëse ke para të mjaftueshme, ose mund të ndalet përmes disa prej kompleksitetëve të kodit të shqiptarit.

Askush nuk duhet të flasë për shqiptarin si njeri pa ligje. Ai zbaton në mënyrë skrupuloze atë që njeh dhe pranon: por, këta janë ligjet që i kanë dhënë natyra dhe traditat, si dhe natyra e paraardhësve të tij shekuj më parë, të "kodifikuar" disi në shekullin XV, ndonëse edhe sot e kësaj

prekur prej gërsërëve, priten me ceremoni. Prerjen e kryen kumbari, që më pas, nëse fëmija është i krishterë lë nga një tufë flokësh për secilën majë të busullës duke krijuar një kryq. Nëse është mysliman, tri tufa për të formuar një trekëndësh. Në rastin e hakmarrjes, burri nuk duhet prekur nëse shoqërohet nga një fëmijë apo një grua.

## Personalitet i pathyeshëm

Sot, shqiptari është personaliteti më piktoresk në Evropë. Megjithatë, po aq interesante sa tiparet e tij, është edhe e ardhmja e tij politike. Kohët e fundit është shfaqur vetëdija kombëtare shqiptare që refuzon të shtypet. Nën qeverisjen jonormale të turqve, racat e ndryshme të krishtera të Perandorisë, si armenët otomanë, bullgarët otomanë dhe grekët otomanë, kanë secila ekzistencën e tyre kombëtare, një shtet brenda shtetit, ndo-

e tij – është fakti që shqiptari është një prej anëtarëve më individualistë të racës njerëzore. Po të mos kish qenë i tillë, ai do e kishte humbur shumë kohë më parë identitetin e tij, duke u shkrirë me popujt e ndryshëm që përgjatë kohërave u kanë ardhur rrotull maleve shqiptare. Pavarësisht sulmeve të vijueshme të romakëve, gotëve, serbëve dhe bullgarëve dhe 350 viteve dominim të Turqisë, shqiptari e ka ruajtur individualitetin e tij të pathyeshëm. Crispi, burri i shtetit Italian ka qenë me prejardhje shqiptare. Ai ishte pjesëtar i kolonisë së madhe të shqiptarëve në Sicili dhe Italinë e jugut, paraardhësit e të cilit, afro njëqind mijë, emigruan, kur Turqia pushtoi Shqipërinë. Edhe sot e kësaj dite, shqiptarët e Italisë e ruajnë prejardhjen e tyre. Mosgatishmëria ose paaftësia e shqiptarëve për të ndryshuar individualitetin e tyre reflektohet tragjikisht në



dite nuk janë hedhur asnjëherë në letër. Disa prej rregullave të çuditshëm që udhëheqin jetën e tij janë: Persona që e kanë prejardhjen nga një stërgjysh i përbashkët mashkull, përmes linjës mashkullore, e konsiderojnë njëri-tjetrin vëllezër, ose vëlla e motër, e si pasoja martesë brenda fisit përjashtohet. Të rinjtë mund të betohen për vëllazëri, dhe kjo krijon një marrëdhënie që i nënshton të dy, bashkë me pasardhësit e tyre të disa brezave, para të njëjtëve ligjeve martesore që rregullojnë edhe lidhjet e gjakut.

Personat që kanë të njëjtin kumbarë nuk mund të martohen, dhe ka dy lloj kumbarësh: ai i pagëzimit dhe ai i flokut. Kur një fëmijë, vajzë apo djalë, mbush 2 vjeç, flokët e tij që deri atë çast nuk janë

nëse gjithmonë të nënshtuar vullnetit të turqve. Shqiptarët, ndonëse në përgjithësi kanë zhvilluar një lloj besnikërie myslimane që u jep një pothuajse solidaritet me turqit, janë të vendosur që të kenë edhe ata një entitet kombëtar.

Ndonëse janë të mallkuar me prapambetjen që ka shoqëruar pak a shumë kudo besimin muhamedan, liderët e tyre e kuptojnë se nuk janë një racë orientale, por perëndimore. Se tiparet e tyre turkomuhamedane janë një lustër, dhe se do të mjaftojë një brez me shkollimin e duhur për të bërë kërcimin e madh përpara dhe për të zënë vendin e tyre mes racave të qytetëruara të gadishullit të Ballkanit.

Jo i papajtueshëm me nacionalizmin e ri shqiptar – madje mund të jetë arsyeja

ekzistencën e vijueshme të sistemit fisnor shqiptar dhe grindjet e përhershme mes fiseve. Si rezultat, Shqipëria nuk ka mundur të paraqesë një front të bashkuar kundër një armiku të përbashkët.

Vetëm një hero i madh bashkues kombëtar ka dalë për shqiptarët – Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Ai vdiq në vitin 1468, pasi fitoi 21 betejat kundër turqve. Vdekja e tij e la Shqipërinë pa udhëheqës, dhe shqiptarët trima që nuk njihnin besnikëri apo ligj tjetër përtej atij të familjes dhe klanit, ranë në sundimin e Mehmetit II, pushtues i Kostandinopojës. Mehmeti mundi t'i shtypte, por jo t'i nënshtonte shqiptarët. As edhe sulltanët e mëvonshëm nuk kanë arritur ta plotësojnë këtë dëshirë të madhe. Më e mira që mund të



bënin ishte t'i bënin për vete, dhe deri në ditën e fundit të tiranisë së Abdyl Hamitit, shqiptarët trajtoheshin si popull i veçantë. Hamiti ua bleu besnikërinë duke mos u vënë taksa, duke frenuar rekrutimin ushtarak dhe duke përzgjedhur më të mirët e këtyre malësorëve të ashpër si truporjat e tij personale.

#### Turqit e rinj ishin të pamëshirshëm

Kur, pas vitit 1908, turqit e rinj kishin miratuar Kushtetutën e tyre dhe po përpqeshin me shumë mundime të vinin rregull në Perandorinë otomane, trajtimi i Shqipërisë ishte një prej problemeve më delikatë. Duhej të ishte bërë më me kujdes. Përmes një trajtimi delikat, përmbushjes së premtimeve dhe shfaqjes se një simpatie të drejtë për aspiratat e një race injorante, por shumë të zotë, turqit e rinj do të kishin qenë në gjendje të ngrinin dhe forconin në provincën e Shqipërisë një barrierë të padepërtueshme ndaj agresionit evropian. Në vend të kësaj, ata kanë ndjekur një rrugë që është përshkruar siç duhet nga korrespondenti në Kostandinopojë i "Times"-it të Londrës, si politika e rullit me avull. Duke injoruar këshillat e çdo politikani me përvojë, turqit e rinj nxituan t'i "trajtonin" shqiptarët njësoj si fshatarët injorantë turq në Azinë e Vogël. Asnjë strategji tjetër nuk do të kish qenë më e pavend dhe më e destinuar të dështonte.

Shenjat e para te një kundërshtimi u dhanë që në vjeshtën e vitit 1909, por duhej të vinte pranvera e vitit 1910 që një revoltë të merrte përmasa serioze. Në 5 prill të atij viti, shqiptarët myslimanë të skajit verilindor të Shqipërisë rrëmbyen armët kundër qeverisë. Për pak ditë rebelët mbajtën Kaçanikun, por 50 mijë trupa turke u dërguan menjëherë në rajon dhe lëvizja u shtyp. Ajo pati një karakter lokal dhe nuk kishte organizim. Shqipëria si e tërë nuk ishte qëllimi i saj.

Megjithatë, turqit e rinj menduan se kishte ardhur koha t'u jepnin një mësim shqiptarëve të pabindur. Trupat që ishin mbledhur për të shtypur kryengritjen marshuan nëpër Shqipëri. Një divizion shkoi në perëndim, në Shkodër. Ata përshkuan rrugë malore që për breza të tërë ishin mbyllur për këdo që udhëtonte i shoqëruar nga një ushtar turk, sepse shqiptarëve nuk u pëlqente uniforma e autoritetit turk. Por tani malësorët, të zënë në befasi, do të çarmatoseshin. Pas shtypjes që kishin pësuar sivëllezërit e tyre, më të paktë në numër dhe të gjendur përballë automatikëve – një tmerr i pazakontë për shqiptarët e thjeshtë – nuk kishte shpresë për rezistencë. Armët e tyre – krenaria dhe zotërimet – iu morën, dhe shqiptarëve iu "dha një mësim" mizor. Një tjetër divizion i forcave turke marshoi në jug dhe penetroi në luginat paqësore të Shqipërisë.

Në Elbasan, udhëheqësit intelektualë të Shqipërisë së Re kishin hapur një shkollë normale. Ata po përpqeshin të përgatisnin shqiptarët që të bëheshin mësues të bashkatdhetarëve të tyre injorantë në të gjithë vendin. Përdornin gjuhën shqipe dhe, sipas votimit të një kongresi shqiptar të një viti më herët, e shkruanin këtë gjuhë – një gjuhë evropiane – me shkronja latine. Nën Abdul Hamitin, çdo përpjekje për të shkruajtur apo dhënë mësim në gjuhën shqipe ishte shtypur. Vetëm në shkollat e misioneve austriakë dhe ital-

## Shihni fizikun e shqiptarit

sipas reviates franceze

(Le Journal de la jeunesse: nouveau recueil hebdomadaire illustré, 13.6.1880) / nga Ilir Konomi

Një revistë franceze e qershorit 1880, boton këto dy gravura shqiptarësh, shoqëruar me një shkrim të rrallë. Është interesante se si na shihnin të huajt në atë kohë, e kam fjalën nga ana fizike. Zgjedha këtë pjesë: Shqiptarët janë një nga racat më të bukura, ndoshta më e bukura në të gjithë Turqinë. Ata janë më të afërt me grekët sesa me sllavët dhe të kujtojnë tipet më të bukur të malësorëve zviceranë për nga fytyra ovale, hunda e gjatë dhe e hollë, trupi i mpakët dhe format elegante.

Shqiptari ka cilësitë fizike të zviceranëve dhe tirolezëve. Njëlloj si ata, ai është një këmbësor i guximshëm, u ngjitet maleve porsidhitë, me pushkën mbi supë por, në ndryshim prej tyre, ai ka një gjallëri e një gaz prej jugorësh që i shtohen mprehtësisë së tij të jashtëzakonshme, e cila të bie menjëherë në sy.

Ashtu si grekët, shqiptarët dallohen si njerëz që e marrin jetetën me gëzim, ashtu si u vjen. Krenaria kombëtare shfaqet te çdo fjalë e tyre, te gjestet, madje edhe tek ecja e tyre e lehtë dhe herë-herë teatrale.

ianë në veri të Shqipërisë, ku ofrohej propagandë austriake dhe italiane, dhe jashtë survejimit të Sulltanit, kishte qenë e mundur që shqiptarët të studionin në gjuhën e tyre.

Sa për një alfabet, politikanët austriakë që mbështesin punën misionare të priftërinjve austriakë dhe nuk pushojnë asnjëherë së çuari përpara skemat austriake, shihnin me dyshim nga një e ardhme për Shqipërinë, liderët e të cilës të mësuar në Itali apo Austri do të bashkoheshin nga një gjuhë dhe alfabet i përbashkët. Kështu u krijua një alfabet i gjatë dhe iu ofrua fëmijëve në shkollat e misioneve austriakë. Kjo do të ndihmonte për të krijuar të çara për të ardhmen, kur Austria shpresonte që do të trashëgonte këtë tokë dhe do të kishte të nevojshme të përdorte tiraninë e saj dinake për të austrianizuar shqiptarin.

Shkolla normale e Elbasanit, me alfabetin e saj latin dhe e çliruar prej propagandës së huaj ishte një rreze drite në erësirën e Shqipërisë. Ajo nuk kishte ndarje fetare – myslimanët dhe të krishterët ishin vëllezër pa dallim. Themeluesit kishin vetëm një qëllim, lartësimin e racës shqiptare. Ata nuk ishin revolucionarë në kuptimin politik të fjalës. Ata donin të bashkëpunonin me qeverinë e turqve të rinj, dhe vetëm kërkonin që zbatimin e kushtetutës së re të kishte diçka të përbashkët me premtimet e saj themelore.

Por kur ushtarët turq erdhën në Elbasan në verën e vitit 1910, u shpall gjendja e jashtëzakonshme. Të gjithë ata që shiheshin se kishin lidhje me shkollën normale apo simpatizonin përparimin e saj u ndoqën, u sollën para autoriteteve ushtarakë dhe u rrahën në një mënyrë shumë mizore për t'u rrëfyer. Rrahja me thupra dhe kamxhik u zbatuan për shumicën e njerëzve të iluminuar në Elbasan. Financieri i shkollës normale u fshikullua përtej çdo imagjinate. Drejtori dhe shumë prej mësuesve u arratisën. Autoritetet ushtarakë kërkuan dhe rrahën personat përgjegjës për një telegram që ishte dërguar në drejtim të Kostandinopojës, ku kërkohet që mësimi në shkollat shqiptare duhej bërë në gjuhën shqipe dhe me gërma latine. Më tej ushtarët marshuan për të bërë punë të tjera "pasi kishin mbyllur atë shkollë dhe u kishin dhënë shqiptarëve një mësim për t'u mbajtur mend".

#### Kryengritjet e shqiptarëve

Me kalimin e 1910, telashet nisën të

shtohen për turqit në kancelaritë e Evropës, sidomos për skandalin e orgjive të ushtrisë në Shqipëri dhe mbylljen e shkollës normale, ashtu sikurse dhe për çarmatimin brutal të të krishterëve në Maqedoni. Në Evropë ekzistojnë gjithmonë disa palë, interesat politikë të të cilave mund të çohen përpara duke përkrahur të shtypurit. Dhe ndonëse ishin motive hipokritë ata që vunë në lëvizje shumë burra shteti evropianë që ndihmuan për shfaqjen hapur të këtyre ngjarjeve, e vërteta e bëmave të turqve të rinj në Shqipëri dhe Maqedoni gradualisht u bë e njohur për të gjithë.

Turku i ri ishte shfaqur tamam si biri i babait. Udhëheqësit panë që kishin bërë një gabim, por ata nuk do ta pranonin dhe ngjarjet e mëvonshme kanë treguar se nuk ndërruan mendje. Në prill 1911 ndodhi një kryengritje e malësorëve në provincën e Shkodrës, në veriperëndim të Shqipërisë përgjatë kufirit me Malin e Zi. Revolta ishte një prej përpjekjeve të parakohshme dhe të pafata të një populli të dëshpëruar dhe trim, por të përçarë, për t'u hedhur kundër zgjedhës së patolerueshme. Në vend të shndërrohej në një revoltë të përgjithshme, kryengritja mbeti e kufizuar në skajin më verior të Shqipërisë.

Patriotët e vërtetë të të gjithë Shqipërisë i hedhin tutje dallimet fetare dhe fisnore kur gjenden përballë fakteve të mëdhenj të një trashëgimie të përbashkët dhe kundër një zgjedhe të përbashkët. Ata, pjesëtarët e shkolluar të racës së tyre, po luftonin fort vitin që kaloi për një përpjekje të përbashkët në kërkim të drejtësisë për të gjithë Shqipërinë. Fatkeqësisht, këta udhëheqës ishin të keqorganizuar, pa financime dhe pa përvojë. Ata nuk morën mbështetje prej pjesës më të madhe të fiseve myslimanë, shumë prej të cilëve, megjithatë kishin qenë kaq të çarmatosur sa që nuk mund të mendonin të bashkoheshin në një rebelim. Mirditorët katolikë, një fis i fortë në jug të Shkodrës kishin pak pushkë, të gjitha të vjetra dhe hezituan të vijnë në ndihmë të revoltës së malësorëve, deri kur ishte shumë vonë.

Mali i Zi ishte shtylla mbështetëse e kryengritjes, përmes mbështetjes që ai dhe qytetarët e tij i dhanë refugjatëve shqiptarë, të cilët dimrin e mëparshëm kishin kaluar kufirin dhe që në pranverë u rikthyen në Shqipëri, gati për luftë. Në këtë mënyrë u "gropos" thika që për breza të

tërë ishte hequr nga këllëfi mes sllavëve të Malit të Zi dhe shqiptarëve autoktonë.

Por, Mali i Zi u gjend rrezikshëm i përfshirë në çështjet shqiptare, në mospërpqeshje me diplomacinë evropiane dhe sidomos mikun e vet, Rusinë. Kështu që, në fund Mali i Zi e la Shqipërinë në baltë. Pavarësisht këtij fakti, turqit u detyruan të bënin paqe me malësorët rebelë, duke u bërë atyre kaq shumë lëshime, sa që nisën të shfaqen ankesa nga popullsia myslimane e Shkodrës, që nuk ishte rebeluar.

"Çfarë! Ju i ofroni favore rebelëve", thanë ata. "Po kush ju ka qëndruar besnikë, pavarësisht plagëve të vjetra". Ishte njësoj si ankesa e djalit joplangprishës. Fatkeqësisht, turku nuk mundej të zbuste fëmijët e tij besnikë, ashtu siç bëri dikur babai çifut. Sa për marrëveshjen me malësorët, nuk dihej se sa do të zgjaste.

#### Shkollat vetëm do i lehtësojnë

E ardhmja e Shqipërisë varet jo vetëm nga vullneti i Austrisë, Italisë, Malit të Zi që mbështetet nga Rusia, i Greqisë dhe i vetë Turqisë, ku secili prej këtyre është i vendosur që të ketë pjesën e vet shqiptare të tortës. E ardhmja e Shqipërisë varet shumë nga sasia e arsimit që mund të vihet në zbatim përpara se të përcaktohet përfundimisht fati i 2 milionë banorëve. Me përjashtim të Znj. Edith Durham, gruaja angleze që i ka shkelur vetë zonat më të egra dhe të rrezikshme të Shqipërisë, askush nuk e njeh më mirë këtë vend se sa Z. James D. Bourchier, që për një brez të tërë ka qenë korrespondent special i "London Times" në Ballkan. Artikulli i tij i jashtëzakonshëm për Shqipërinë në edicionin e ri të "Encyclopedia Britannica", pasi flet për betejat e grupeve të izoluar të shqiptarëve konkludon: "Rritja e një ndjenje më të fortë patriotike duhet të varet nga përhapja e dhkollimit në popull".

Nëse shkollimi përhapet pa pengesa në Shqipëri, edhe shqiptarët do të fillojnë të kujdesen për vetveten. Shumë prej shqiptarëve të krishterë në qytetin e Shkodrës janë shkolluar dhe kanë siguruar begati, falë italianëve dhe austriakëve. Ata i druhen sidomos fanatizmit të vëllezërve të tyre myslimanë, ndonëse në malet disa kilometra larg, mes familjeve të malësorëve injorantë, si feja e krishterë ashtu edhe ajo myslimane mund të zënë vend nën të njëjtën cati, dhe ritet e krishterë e myslimanë mund të kryhen edhe në një ndërtesë të vetme.

Disa herë autori i këtij artikulli ka pyetur shqiptarë myslimanë të shkolluar, të interesuar për kauzën e racës së tyre, përse nuk u kanë predikuar myslimanëve të Shkodrës dhe gjetkë vëllazërinë mes të krishterëve dhe myslimanëve. Pa hezitim, por me turp dhe me buzët shtrënguar, përgjigja ka qenë çdo herë e njëjta: "Është e pamundur. Myslimanët janë injorantë. Në fillim duhet të shkollohen, pastaj do të kuptojnë".

Pak përpara shpërndarjes së parlamentit, në janar 1912, një deputet shqiptar, njëri prej kryezdhënësve të racës së tij dhe për momentin lider i rebelëve, deklaroi: "Nëse turqit vazhdojnë të të përbuzin joturqit, ata do e rrënojnë vendin e tyre. E them këtë sepse i dua turqit, ekzistenca e të cilëve është e nevojshme për ne". Deputeti shqiptar fliste për popullin e tij.



\*\*\* POEZI \*\*\* \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI



Lulash Brigja

**FLAKË. DASHTNIE!**

E kam mbush një filxhan kafe  
Me dashni për Ty  
Mu ka tha buza prej mallit  
Për me të pa me sy.  
Shpesh ja shoh fundin filxhanin  
Si me ken fallxhore  
S'di magji, por luti Zotin  
Mos me m'lan masdore

E kam mbush një gotë me fjalë  
Nuk mundem me pi  
Me shkronjat e emrit tënd  
Po baj poezi.  
Mbi tastiere të telefonit  
Me shfaqesh si hije.  
Digjet buza prej marakut  
Veç me flak dashtnie

E kam marr një flakë dashtnie  
E kam fut në gji  
Digjet flaka brenda meje  
Prush bahet tek ti  
Shpesh e mbush një gotë me vënë  
Për me shue flakën  
Dikur vonë kur më zën gjumi  
Ëndërr të shoh tan natën.

**N'AT DEKIK KUR...!**

N' at dekik kur Ti  
t' jesh ma e mërzitme se kurr  
Un kisha dasht' me ken i vetmi derman !  
Un kisha me dasht

me ken e vetmja magji,  
E kur t'puthi i here , me ardh n'terezi.  
S'due me ken m'katnor  
as ëngjëll krejt , s'po du mu ba  
Por njat dashtnin që kam per ty  
me askend s'dua me nda

**KU JE...!**

Të kërkoj në rrugët e qytetit  
Nuk je ...As nesër s' do jesh  
Ka mbetur imazhi jot i ëmbël  
Që para syve me buzëqesh  
As gjurmët e tua në rërë  
As kafja jote mbi tavolinë  
Veç dielli i skuqur në horizont  
Dhe malli që puthet më vetminë..

Ti je ..... atje ku nuk je..!  
Aty ku ke shpirtin mungon...  
Po ikin korriku e gushti  
Dhe dielli mbi liqen perendon..  
Shpreso tek ylberi i vjeshtës..  
Mbase do ndodh mrekullia..  
Nga shtigjet e të pamundurës  
Rruga të çon tek dashuria...

**PA TITULL ..!**

M'jan shprish  
Fjalt n'poezi

Si me pas ra breshen n'fun t'majit  
Deshta me i kthye mbare  
Dy tre rreshta  
E me ti nis n'shëj mallit

Aq shumë m'ka marr uja  
Për ty  
Sa kam nis me bashkue  
Dramcat e mbetuna  
Nga darka e mrame si kjetme bashke

Ditën kqyri tash e pare  
Ku po t'shoh  
E natën sterkatem  
Me men derisa lodhem  
I bindun se shpirtin  
Se man buka po dashnia.

**SY BUKURA..**

Me muzën e syve të tu  
E puttha ëndrën time të vrrarë  
Që lind sa herë jemi bashke  
E vdes kur jemi të ndarë

Në dritën e vetetimave të rastit  
I grisa letrat e mëkatit  
Vargjet i shkrova në faqe  
Pastaj kafshova buzët e fatit

Me flladin e kujtimit të mbetur.

Ndërtova një urë në hapësire  
Se bota është prishur shumë.  
Pak kan mbet njerz të mirë

Nata e hodhi ëndrren në sirtar  
Dita u bë pikturë me re e diell.  
Mbi to e pash imazhin tënd  
A thu u bëre ylber në qiell.

Sybukura ime që je larg.  
Që shfaqesh e ikën si meteor.  
Fjalet për ty i bëra varg  
Ngadale ti shkrova mbi krahëror

**URË ME VARGJE ..**

Një det në mes as urë as shteg  
Unë në një anë Ti në tjetrin breg  
Puthemi me sy flasim me duar  
Unë ëndërr e fjetur Ti ëndërr e zgjuar

Kur ishte ura. nuk ishim ne  
Tani me thua - Hajde ku je..  
Ky det i ndarjes s'po shterret dot.  
avullojn shpresat mbushet me lot

As bashkë s' po jemi por as të ndarë..  
Ti ëndërr e vyshkur. Unë ëndërr e vrrarë  
Dua të kujtoj një thënje e vjetër..  
mos ler asgjë për botën tjetër

**Ju njohim me qytetin me popullsinë më të madhe në planet**

Një tjetër qytet ka fituar titullin me popullsinë më të madhe në planet. Ka më shumë se 32 milionë banorë të përhershëm dhe është një nga vendet më misterioze në botë. Bëhet fjalë për qytetin Chongqing, i cili ndodhet në jugperëndim të Kinës. Në fakt, pak kemi dëgjuar për këtë qytet dhe arsyeja është se në Kinë nuk është qyteti më i rëndësishëm dhe kështu lajmet nga vendi më i populluar në botë vijnë kryesisht nga Pekini dhe Shangai.

Chongqing është plot me rrokaqiej, ura futuriste dhe një metro që në disa pjesë kalon nëpër ndërtesa. Të vizitosh këtë qytet kinez është jo vetëm interesante, por edhe shumë e lirë. Kostoja e jetesës është e ulët. Kjo është arsyeja pse të qenit turist në Chongqing ju lejon të vizitoni të gjithë qytetin të qetë dhe pa shpenzuar shumë. Chongqing është aq i madh sa për ta kaluar atë nga një vend në tjetrin, mund të duhen dy ditë.



**Shqiptari ka frikë nga e ardhmja**

Shqiptari ka frikë se mos, në vend që të sigurojë lirinë, për të cilën është lutur dhe ka luftuar, malet e tij të shtrenjta dhe luginat pjellore do të ndahen mes shteteve ndërluftues, dhe se mos ai absorbimet nga një racë e huaj. Austria kërcënon të vijë nga Veriu. Italia kanos nga përtej brigjeve të Adriatikut. Këta janë dy armiq që shqiptarët i urrejnë më keq se sa turqit, pavarësisht shkollave, spitaleve dhe kishave që përfaqësuesit e tyre kanë ndërtuar në veriperëndim të Shqipërisë. Shqiptarët i tremben Austrisë dhe Italisë tamam si një polak profetik mund t'i jetë trembur tre grabitësve të tokës mëmë. Shqiptarët i druhen po kështu një konference evropiane për këtë qëllim, se mos Mali i Zi dhe Greqia lejohen që të zgjerohen në kurriz të shqiptarëve. Alternativa

ideale që ai do të dëshironte, është një Turqi e mirëqeverisur, për të cilën ai do të jetë një prej "ledheve mbrojtës".

Megjithatë, breza të tërë sundimi turk i kanë mësuar se nuk duhet të presë drejtësi nga turqit. Revolucioni i korrikut 1908 ofroi një rreze të përkohshme shprese, por errësira e dëshpërimit u rikthye menjëherë, më e zezë se më parë. Ndërkimi me thupra, plumbi dhe qelia e burgut kanë qenë shpërblimi i vetëm pas kërkimit për "diçka më të mirë". Është e vërtetë që, shqiptarët që kishin qenë neglizhuar për shekuj të tërë nuk ishin të gatshëm që të pranonin me mirësi disa prej kushteve të "Konstitucionalizmit". Fshatari injorant, që nuk ka paguar asnjëherë taksa dhe nuk është riregjistruar asnjëherë për shërbimin ushtarak, nuk e vlerësonte "barazinë" e re, që iu manifestua atij përmes pagesës së taksave ashtu sikurse të gjithë banorët

e tjerë të Turqisë, si dhe për kontributin e kuotave të tij për martirët në tokat e largëta të Jemenit.

Shqiptarët kanë shumë gjëra për të mësuar. Shkollimi mund të kishte ardhur tashmë përmes udhëheqësve të tyre të iluminuar. Por turku budalla bëri të vetmen gjë që dinte të bënte – ai marshoi me ushtri drejt Shqipërisë. Si pasojë, në vend që të shfrytëzonte shanset e një besnikërie entuziaste, ai rrënjosi edhe më tej ndjenjat e kahershme të mosbesimit dhe urrejtjes.

Spekulimet për të ardhmen e Shqipërisë të çojnë vetëm në labirinte të papenetrueshëm, pasi problemi i Shqipërisë është i lidhur ngushtë me Çështjen e Lindjes, ajo që ka munduar Evropën për breza të tërë. Lufta e Krimesë u luftua për ta zgjidhur atë, por në një formë më të komplikuar ajo u rikthye në luftën ruso-turke 1877-1878. Të dërguarit e Evropës

në Berlin në vitin 1878 djalloshën Traktatin e Berlinit. A mos është shumë të shpresojmë që ka ardhur koha për daljen e një brezi më dashamirës diplomatësh? Megjithatë, Lindja e Afërt shpreson gjithmonë për një zgjidhje dhe për t'u dhënë fund kushteve që, me turqit e vjetër dhe tanimë të rinjtë, po e bëjnë Perandorinë Otomane thjeshtë një legjendë.

Sot shqiptarët, arabët, armenët, bullgarët, grekët, serbët dhe vetë turqit po vuajnë, siç ka ndodhur prej dekadash, nga plaga e sundimit turk. Nga këta popuj të pafat, shqiptarët janë të parët që duhet të tërheqin vëmendjen e një bote joegoiste.

*Nga Theron J. Damon  
National Geographic,  
numri i Nëntorit 1912*

**Solli për botim prof. dr. ZEF GJETA**



# N/Kolonel KOLË VOCAJ

Kush është N/kolonel Kolë Vocaj?

Kola ka lindur me 7 qershor 1942 në fshatin Fushë-Kuqe të Kurbinit, i biri i Tomë e File Vocaj. Toma është nga Plani; ndërsa Filja nga fshati Sumë (Bruçaj). Prindërit e tij, për arsye ekonomike, në vitin 1937 u larguan nga vendlindja dhe u vendosën në fillim në fshatin Fushë-Kuqe dhe në vitin 1950 u rivendosën në fshatin Gajush të rrethit të Lezhe dhe u morën me bujqësi.

Shkollën fillore e 7 vjeçare e përfundoi në fshatin Gajush dhe në Zejmen.

Në vitin 1957 u formua kooperativa bujqësore, dhe u bënë anëtar të saj. Në vitin 1959 bashke me një bashkëfshatar të tij, Kola morri pjese në lëvizjen e arritjes së rendimenteve të larta në kulturat bujqësore. Në 10 dynym të tokës së mbjelle me misër morën 100 kv/ha. Për këtë arritje shkruante edhe shtypi i kohës.

Në vitin 1961 filloi studimet e larta në Shkollën e Bashkuar, për oficer në Tiranë, në fakultetin e Logjistikës, të cilën e mbaroi në vitin 1964 dhe u gradua n/toger. Shkollën e mbaroi me rezultate të mira



N/Kolonel Kolë Vocaj, në vitin 1992



Bashkëshortët Kolë e Arzime Vocaj



Vëllezërit Tonini, Kola e Gjergji Vocaj

e shumë të mira. Po atë vit u emërua në Brigadën e 16-të Këmbësorisë (Br16K), në qytetin e Gramshit, me detyrën e shefit dhe në vitin 1968 emërohet në detyrën e shefit të logjistikës.

Në vitin 1966 u martua me Arzime Vocaj dhe patën 2 fëmijë, Gentianin dhe Leonardin.

Në vitin 1971, Ministria e Mbrojtjes e dërgoi për studime në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Ekonomik, të cilin e mbaroi në vitin 1975 me rezultate të mira. Po atë vit u emërua në grupin e inspektorëve të Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë detyrë ka punuar deri në vitin 1991.

Është dalluar në punë për korrektësi, ndershmëri dhe profesionalizëm. Në vitin akademik 1985-86 ka studiuar në Shkollën e Partisë së Punës, në kursin e lartë për Ekonomi Politike, me rezultate shumë të mira.

Në vitin 1991, me kërkesën e tij u emërua zëvendës komandant dhe shef logjistike në Brigadën e Ndërhyrjes së Shpejte në Tiranë.

Në 1992 është liruar me gradën N/Kolonel, pas reformës në ushtri.

Sot është pensionist.

**Ndue Mici**

## Çfarë ishte Rruga e Mëndafshit dhe çfarë ndodhi me të?

Dinastia kineze Han e mirëpriti tregtinë me Perëndimin që rreth 2000 vjet më parë. Por oborrtarët e saj nuk mund ta imagjinonin se ishin duke krijuar themelet e njërit prej sistemeve më të vjetra, më të mëdha dhe më jetëgjata të tregtisë në botë. Gjatë gjithë ekzistencës së tij 1600-vjeçare, sistemi i lashtë i Rrugës së Mëndafshit i rezistoi ngritjes dhe rënies së kulturave dhe qytetërimeve të panumërta, duke dalë edhe më e fortë nga cilado përvojë e tillë. Po cilat ishin ngjarjet që e përcaktuan historinë e Rrugës së Mëndafshit dhe pse mori fund ky sistem?

Një koleksion i ngatërruar rrugësh që ndryshonin vazhdimisht, kjo rrugë i zhvendosi mallrat nëpër Azi dhe Evropë nga viti 130 Para Krishtit deri në vitin 1450 Pas Krishtit. E quajtur zakonisht Rruga e Mëndafshit, ky sistem tokësor dhe ujor shtrihej në një gjatësi prej 9600 km dhe lidhte shumë territore, nga Kina, India dhe Irani deri në Itali.

Duke kaluar nëpër terrenet më të vështira si malet, shkretëtirat, stepat dhe detet, sistemi nisej nga kryeqyteti i lashtë i Kinës Xian në Azinë Qendrore dhe Perëndimore dhe mbaronte në Mesdhe. Rruga e Mëndafshit transportonte të gjitha llojet e artikujve si kripën, erëzat, gurët e çmuar, metalet e çmuara, letrën dhe porcelanin.

Por në fillim ai u bazua në eksportin e pëlhurës së mëndafshit që prodhohesh ekskluzivisht në Kinë. Në atë kohë, oborrtarët e mbretërisë së Kinës e kuptuan se mëndafshi vlente shumë në shoqërinë e tyre ndaj ata i cilësuan si një sekret shtetëror metodat e prodhimit të tij.

Por ata nuk ishin plotësisht të vetëdijshëm mbi vlerën e pëlhurës së mëndafshit në Perëndim, pasi tregtia e vetme e jashtme e tekstitit ishte pjesë e diplomacisë së tyre. Për shembull kur fiset e popullit Xiongnu plaçkitën kufijtë e Kinës rreth vitit 200 Para Krishtit, dinastia Han

u siguroi fiseve sasi të mëdha mëndafsh si pjesë e lutjes për paqe.

Dhe kur fiset e popullit Xiongnu ishin ende duke plaçkitur kufijtë e Kinës rreth vitit 130 Para Krishtit, dinastia Han u dhuronte të fiseve mëndafsh në këmbim të një lloji të veçantë kali më të shpejtë dhe më të fortë, i cili ishte i rëndësishëm në humbjen e popullit Xiongnu disa dekada më vonë.

Këto ndërveprime, përveç një sërë misionesh të dërguara në kërkim të aleatëve të huaj, zbuluan për herë të parë dëshirën e madhe për mëndafsh të popujve në Perëndim. Dhe sapo u zbulua kjo gjë, oborrit mbretëror i Kinës krijoi një grup të madh tregtarësh të pëlhurave dhe i dërgoi ata drejt perëndimit në një përpjekje për të nxitur marrëdhëniet e ardhshme tregtare dhe për të zyrtarizuar rrugët e ardhshme tregtare.

Ishin pikërisht këta tregtarë që filluan krijimin e Rrugës së Mëndafshit, edhe pse nuk ishin të vetmit udhëtarë që u bënë pjesë e atij sistemi. Tregtarët nga e gjithë Azia Qendrore dhe Perëndimore nxituan drejt kësaj rruge, duke ia transferuar mallrat e tyre tregtarëve kinezë përpara se këta t'ua shisnin të tjerëve.

Udhëtimi i tyre ishte i vështirë. Tregtarët përballeshin me kërcënimet e terrenit të ashpër, kushteve atmosferike ekstreme apo grupet e hajdutëve që sillshin rreth Rrugës së Mëndafshit. Por për shkak se mallrat e tyre ishin shumë të kërkuara, tregtia vazhdoi për shekuj, duke i mbijetuar disa prej ngjarjeve më të zymta të asaj kohe.

Historianët flasin zakonisht për 3 faza të tregtisë në këtë rrugë, ku që të gjitha dallojnë nga përzierja e tyre e dallueshme e tregtarëve, mallrave dhe sfidave politike. Faza e parë e kësaj tregtie u zhvillua rreth vitit 200 Para Krishtit deri në vitin 220 Pas Krishtit dhe u përqendrua në lëvizjen e

mëndafshit nga Kina në Romë, ku njerëzit ishin të ndarë në lidhje me këtë tekstil.

Disa romakë mendonin se veshja me mëndafsh ishte një simbolike e përshatshme e vlerës, pasurisë dhe autoritetit të tyre, ndërsa të tjerë e shihnin mëndafshin si një kënaqësi të pahijshme dhe u përpoqën të ndalonin importimin e tij. Pavarësisht këtij debati, importet romake të mëndafshit u rritën gjatë gjithë kësaj faze, të mundësuar nga paqja dhe prosperiteti që siguruan perandorët e hershëm të Romës. Faza e dytë nisi në 220 Pas Krishtit, kur Kina u zhyt në një periudhë trazirash politike, gjë që solli një tërheqje të saj të përkohshme nga tregtia e Rrugës së Mëndafshit. Për shkak të trazirave, sekretet e prodhimit të mëndafshit u nxorën jashtë shtetit, duke i dhënë fund monopolit kinez mbi materialin.

Pasi dinastia Tang e Kinës riktheu normalitetin rreth vitit 600 Pas Krishtit, prodhuesit e mëndafshit po shfaqeshin tashmë në Bizant, që ndodhej në gadishullin e Anadollit, dhe që shërbeu si një pasardhës i shtetit në rënie të shpejtë të Romës. Për shkak se cilësia e mëndafshit kinez ishte ende superiore, një fazë e re e tregtisë së mëndafshit u ngrit nga rreth 620-910 pas Krishtit, këtë herë nga Kina në Bizant dhe më gjerë.

Duke filluar nga Azia Qendrore dhe duke përparuar në Kinë, Indi, Iran dhe Anadoll, pushtimet e mongolëve nën Genghis dhe Kublai Khan e stabilizuan të gjithë kontinentin, duke lehtësuar komunikimin dhe tregtinë në të gjithë Euroazinë. Ndërsa qendrat e ndryshme tregtare të Azisë dhe Evropës ranë nën kontrollin e unifikuar të Mongolëve, filloi një lulëzim i tretë dhe i fundit i tregtisë së mëndafshit, që zgjati rreth vitit 1210 deri në vitin 1360 pas Krishtit.

Ndërsa mëndafshi ishte ende një nga produktet kryesore që udhëtonte në

Rrugën e Mëndafshit, tekstili u dërgua në Perëndim së bashku me perlat, gurët e çmuar, erëzat, qeramikën, qilima etj. Përveç këtyre mallrave, hapja e mongolëve ndaj të huajve dhe ideve të huaja lehtësoi gjithashtu lëvizjen e njerëzve, filozofive dhe patogjenëve nëpër shtrirje të mëdha të Rrugës së Mëndafshit.

Pavarësisht se mbijetoi dhe ndonjëherë lulëzoi, tregtia e Rrugës së Mëndafshit filloi të binte rreth vitit 1360 pas Krishtit. Kjo për shkak të pasojave të murtajës bubonike gjatë Vdekjes së Zezë rreth 20 vjet më parë por edhe ndarjes së Perandorisë së madhe Mongole.

Goditja vendimtare ndodhi rreth vitit 1450 pas Krishtit, kur taksat e vendosura nga Perandoria Osmane në lulëzim e sipër, e penguan pothuajse të gjithë tregtinë e mbetur përgjatë rrugëve tradicionale të Rrugës së Mëndafshit. Kjo i detyroi tregtarët evropianë të kërkonin rrugë alternative drejt qendrave tregtare të Azisë.

Duke nisur një epokë të re të tregtisë dhe kontaktit ndërkulturor, në të cilin udhëtarët do të kërcejnë midis "Botës së Vjetër" dhe "Botës së Re" me pasoja dramatike dhe shkatërruese, kërkimi për rrugët detare vetëm sa e përshpejtoi zhvendosjen e vëmendjes nga Rruga e Mëndafshit.





# Dede Marashi, ruajtja e trashëgoj traditat e prejardhjes

## Kush është Dedë Marashi?

Dede Marashi, ka lindur me 21 dhjetor 1936, i biri i Ndrekes dhe i Mrikës (Mrika bijë Gjuraraj, halla e Gjelosh Kolës), në fshatin Gurëz të rrethit të Kurbinit. Me origjinë nga fshati Thethi, Kryeqyteti i Alpeve Shqiptare, i krahinës së Shalës. Familje e njohur në Dukagjin, por edhe më gjerë, për bujari, besë, burrëri e trimëri, si shtëpia e Sokol Marashit në fushë të Thethit.

Ashtu si një pjesë e familjeve të mëdha të fshatit, të krahinës e të zonës së Dukagjinit, u zhvendosen për në fshatin Gurëz, në vitin 1896, 127 vjet më parë. Në fillim është ulur axha i Dedës, Sokol Mrashi dhe më vonë, është ulur Ndreka, baba im, thotë Deda.

Deda thotë, babe Ndreka e nëna Mrikë patën pesë djem (Rrokun, Markun, Tomën e Deden) dhe një vajzë (Mrinë), unë isha i katërti nder djemtë.

Kjo familje, në vitin 1939 ka lëvizur për në rrethin e Lezhës, në fshatin Shënkoll. Sot numërohen me dhjetëra familje nga ky trung. Për të cilat thuhet fjalët më të mira.

Integrimi i kësaj familje në bashkësinë e Lezhës, është bërë në harmoni me traditat e origjinës. Pozitive ka qenë se asnjëherë nuk e kanë harruar Thethin, i cili është "qershia mbi torte e Alpeve".

Këto familje, që tani janë bërë lagje, janë të shkolluar dhe të mirë punësuar. Kanë biznese të shumta, duke filluar nga Lezha deri në Theth. Pozitiv është fakti se këto nuk e harruan kurrë prejardhjen, madje mendojmë se kanë marrë një pjesë të ajrit të pastër, ujit të kristaltë dhe bukurinë e luleve. Dhe traditat e shkëlqyera të Dukagjinit.

Deda, në vitin 1966, me Lenën, një vajzë nga fshati Vukel, i krahinës së Kelmendit, i një familjeje të nderuar dhe e respektuar në të gjithë Kelmendin. Lindën e rritën tre fëmijë, dy djem (Eduartin e Arbenin) e një vajzë (Verën), të cilët i edukuan dhe i shkolluan në mënyrën më të mirë të mundshme. Tani ata janë bërë prindër dhe Deda ka disa nipa e mbesa, të cilët e duan dhe e respektojnë shumë.

Deda u rrit, u shkollua dhe u bë kuadër me rëndësi në rrethin e Lezhës. Ku do që ka punuar e drejtuar rezultatet kanë qenë të larta. Për 20 vite punojë drejtor në SMT. Fillojë me krijimin e kësaj ndërmarrje, me një grup të vogël punonjësish dhe arriti të ketë 700-720 punëtor. Kjo ndërmarrje u bë shembull në shkallë Republike, ku janë organizuar me dhjetëra mbledhje për eksperiencë, në organizimin dhe drejtimin e realizimit e objektivave. Madje ka zënë vendin e parë në shkallë Republike. Afësitë organizuese e drejtuese të Dedës bënë që pushteti i kohës ta vlerësojë. Arriti të bëhet anëtar i Byrosë së Partisë së Rrethit Lezhë. Në ato ekonomi ku nuk kishte rezultate, pushteti i kohës, gjente "Mjekun" për t'i nxjerrë nga prapam-

betja. Ky ishte Dedë Marashi, kuadër me arsim të lartë e me eksperiencë të shkëlqyer në drejtimin e organizimit e punës. Kështu në vitin 1976 zgjidhet



Kryetar i Kooperativës Bujqësore në Ishull- Shëngjin, të cilën e drejtojë për shumë vite, dhe arriti rezultate të larta në plotësimin e detyrave. Një ekonomi, e cila ishte drejte recensionit total, ishte ajo e Dajçit të Zadrimës, që duhej një



kuadër me aftësi organizuese, drejtuese e mbi të gjitha i lidhur me masën, pra me kooperativistët për ta nxjerrë nga kjo gjendje. Në vitin 1988, Deda zgjidhet kryetar i kooperativës në Dajç. Shpejt arriti të mobilizojë kooperativistët dhe



të arrijë rezultate të kënaqshme, rriti vlerën e ditës së punës. Kjo arritje u realizua në saj të lidhjes të fortë me popullin e kësaj krahine. Populli punëtor, ky i mrekullueshëm, punëtor e bujar. Kudo ku ka punuar edhe sot e kësaj dite e kujtojnë me respekt emrin e Dedë Marashit. Kjo falë besimit që krijoi me njerëzit, duke kapë kudo psikologjinë e punës dhe shpirtin e kolektivit. Kur bisedon me Dedën, për këtë periudhë ai shprehet: "Të gjithë popullit, punëtorëve, kooperativistëve, kudo që kam punuar u kam borxh, sepse më kanë mbështetur dhe respektuar. Të vetmen kritikë që pushteti i kohës ka bërë është se nuk ka zhvilluar luftën e klasave. Pra, e kanë quajtur liberal.

Deda, është për tu theksuar se asnjëherë nuk e harroi origjinën. Çdo vit ai familjarisht pushimet i ka bërë në Theth. Jo vetëm pushimet, por ka marrë pjesë në çdo gëzim apo hidhërim të Thethjanëve, duke iu trashëguar edhe fëmijëve, nipave e mbesave ndjenjën e origjinës. Kështu djemtë e tij kanë investuar në Theth, duke ndërtuar dy vila, bujtina me parametra bashkëkohore, të

cilat do i kishin zili edhe në Zvicër.

Dede Marashi është nder themeluesit e parë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" së bashku me të paharruarin Nikollë Vocaj, me Fran Markun, në vitin 2003 dhe që në fillim është zgjedhur Kryetari i saj, për degen e Lezhës.

Nuk është e lehtë të shkruash për një burrë si Dedë Marashi, të cilin ne e kemi simbolin e burrit Dukagjinas, me zemër të madhe, me horizont dhe mbi të gjitha i thjeshtë. Ju përshtatet të gjitha moshave, bashkësive dhe origjinës të gjithë secilit. Ne krenohemi si Dukagjinas, po edhe Lezhjanet me këtë figurë, i cili ndonëse në moshë 86 vjeç nuk të jepe as për 60 vjeç.

Ne i urojmë të plotësojë mbi 101 Pranvera, me atë shëndetin që ka sot.

\*\*\*

**Ndue Sanaj: Njohja e ime, me familjen e Dede Marashit, "mësuesit" tim të parë!**

Me 15 maj 1947, axha Gjeto apo Baci siç i kemi thënë të gjithë fëmijët e kësaj

shtëpie, shtëpisë së Sanajve dhe Doda, baba i im, me thirrjen që ju bë për të përfutur tokë nga Reforma Agrare e vitit 1946, lëvizin nga fshati Gjuraraj për në rrethin Lezhë, në fushën e Bregut të Matës, në fshatin Shënkoll, në pronën e turkajve, të cilët në atë kohë përfaqësoheshin nga Nikoll Dede Kaçeli.

Me dhënien e tokës, ju dhanë dhe shtëpi. Shtëpia ishte kasolle për lopët e turkajve, anash me dërrasa dhe e mbuluar me tjegulla, pa tavan. E kanë pastruar dhe kanë vijuar të banojnë në te. Kanë bërë përpjekje të mbushin hapësirat në mes dërrasave, sepse kishte hapësirë në mes tyre, që jo vetëm nëpërmjet tyre të shikonin nga jashtë-brenda, por dhe futesh shumë erë, në veçanti kur ishte murrilani.

Buka që kishin marrë në Gjuraraj, prej kohës së nxehtë, ishte mykur dhe nuk mund ta hanin nga hidhërimi që kishte marre. Baba Dode më tregonte:

*"Atëherë, pasi e kemi tharë dhe e kemi shtypur për ta kthyer në formë miell, e kemi çuar te Mrika e Ndreke Shalës, për ta bërë përsëri bukë. Ndreke Marash Shala, prej fshatit turistik, Thethi, në fillim vendosur në fshatin Gurez dhe pastaj, në vitin 1939 ishte vendosur në Shënkoll, i cili e ka pas bashkëshorten, Mrikë Preken, prej fshatit Gjuraraj, hallën e Gjelosh Kole Prekes. Prandaj, jo vetëm si dukagjinas, por mbi të gjitha e ka prit Gjeton e Doden, si vëllezër të vet dhe u ka gatua bukën ... Kjo familje kishte pesë fëmijë, katër djem, Rrokun, Markun, Tomen e Deden dhe një vajzë, Mrinë.*

*Ajo, Mrika, pasi "miellin" e ka përzier me miell tjetër të rregullt, ka gatuar bukën, por nuk hahej, kishte dal shumë e hidhur. Mrika, atëherë ju gatuan bukën e re, me miell të pastër. Pasi e falënderojnë, me urimin: "Ta paçim borxh o motër, Mrika e Ndreke Shalës!" Morëm bukën e nisemi për te kasolle. Gjatë rrugës, prej urie, kemi hëngër bukën thatë dhe deri tek kasolle kemi hëngër gjysmën e saj. Kur jena futur në kasolle, jena ulur për të pushuar. Na kishte zanë buka dhe jena përmendur pas 24 orëve. Fati i jonë, në të nesërmen kemi një gjallë".*

Pasi axha e baba ndërtuan shtëpinë e re dhe unë u bëra të shkoj në shkollë, mësuesi im i parë ka qenë Deda Marashi, i cili çdo ditë më kontrollonte mësimet dhe më pyeste ..., çka më nxitte të mësoj se më shumë.


Mirënjohje për jetën e punën e Dede Marashit!

**Agetina Martini**, me banim në Itali, me shkruan: "Kam punuar me Dede Marashin në SMT dhe Ai kam përshtypjet nga më të mirat për punën e tij, njeri e drejtues i arsyeshëm, me intelekt dhe jo hakmarrës, njeri që krijonte paqen me të gjithë, duke zgjidhur problemet si duhet. Njerëzve, punonjësve, në përgjithësi ju ka bërë shumë të mira të merituar".

**Përgatit Ndue Ziçi**



# Shtatë mënyra për ta neutralizuar tipin narcist



Tipi narcist, është shumë i njohur dhe, i përhapur në jetën sociale. Sipas psikologjisë, në çdo komb, 10 deri në 15 përqind e popullsisë, vuajnë nga çrregullime narciste të personalitetit. Meshkujt vuajnë rreth 7.7 përqind dhe femrat rreth 4.8 përqind.

Narcizmi nuk është punë maske, është sëmundje e çrregullimeve psikike. Tipi narcist vuan nga ideja e madhështisë, nga mungesa e empatisë dhe, vazhdimisht kërkon që të jetë në qendër të vëmendjes. Ai është i bindur se, qëndron mbi gjithë të tjerët dhe, është i lindur për të sunduar gjithë të tjerët.

Tipi narcist, kudo që ndodhet, mendohet burim konfliktesh, tensionesh dhe dhune. Asnjë copë rrugë, asnjë marrëveshje, nuk është e sigurtë me atë.

Sjellja dhe marrëdhëniet me tipin narcist, nuk janë të lehta. Si i bëhet halli, kur në mesin tonë, janë kaq shumë tipa të tillë!?

Psikologët e kanë menduar të mundshëm neutralizimin e këtij tipi dhe, rekomandojnë shtatë mënyra:

## 1. Mëso të thuash Jo!

Tipi narcist, gjithmonë vuan nga „uria“ për mirënjohje, edhe kur nuk i duhet, për ta ushqyer personalitetin e vet. Vazhdimisht është në kërkim të saj. Nëse grindesh me tipin narcist, është shumë mirë dhe, me shumë sukses, fjala „JO“, para se gjendja të eskalojë. Fjala „JO“ nuk është vetëm një fjalë magjike, si mjet i mundshëm, për ta neutralizuar narcistin. Është një „kolonë mbështetëse“, për neutralizimin e të gjithë tipave të pakëndshëm. Kjo fjalë, duhet mësuar dhe guxuar për ta përdorur në kohë. Këta tipa, mundohen që, mendimet, sjelljet dhe veprimet e tyre, t'ua imponojnë gjithë të tjerëve. Për këtë, ata përdorin të gjithë teknikën e mundshme, që nga manipulimi, korruptimi, kulaçin dhe kërbacin. Nëse ti, e mëson në kohë dhe, guxon ta përdorësh fjalën „JO“, kundër kësaj sjellje të dëmshme, ke ndërtuar një kufi solid, me personin që vuan nga

çrregullime të forta narciste të personalitetit. Ti e bllokon atë që, të të kontrollojë dhe manipulojë. Ia heq mundësinë që ta shtrijë egon e vet mbi ty. Nëse ti, e injoron atë, e ke goditur gjarprin në kokë, e ke kapur problemin në rrënjë.

Fillo të mendosh se, ti, nuk e meriton keqtrajtimin dhe, nuk je aspak i gatshëm ta tolerosh.

Mëso dhe, guxo, të thuash „JO“.

## 2. Mos u përqendro tek tipi narcist.

Tipi narcist, gjithmonë kërkon vëmendjen e të tjerëve. Gjithçka që ai, bën dhe thotë, janë mjete për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve. Nëse ti nuk tregon vëmendje, për ato gjëra që thotë dhe, bën ai/ajo, ti bën të kundërtën e dëshirës së tij, gjë kjo që, e bën të mendojë. Ai nuk e duron dot injorimin. Pushon së vepruari apo së foluri ose, largohet.

## 3. Ruaje gjakftohtësinë.

Tipi narcist, ka një boshllëk në mekanizmin e ndjenjave, nga lloji dhe masa. Ai nuk i njeh turpin, pendimin, dhimbjen, keqardhjen. Mendohet tipi „zgvër“. Si i tillë, ai, vazhdimisht provokon tensione, grindje dhe konflikte. Ka një mbivlerësim të pazakontë në vlerat e veta, është egoist i pakufi.

Ky tip, shpesh, funksionon shumë mirë në shoqëri, ka aftësi komunikimi dhe, shfaq vlera për t'i pasur zili. Kjo ndodh me ata që nuk e njohin dhe, për fat të mirë, nuk kanë të bëjnë me atë.

Ti, nëse jeton apo punon me një të tillë, është fare normale që të bëhesh nervoz, deri në humbjen e kontrollit mbi vetveten. Ruajtja e qetësisë, shmangia e frikës dhe, besimi në vetvete, janë mjete më i mirë për ta neutralizuar atë. Gjakftohtësia me tipa të tillë, është mençuri dhe, mjete më i mirë për të përballuar konfliktin.

## 4. Tregoja menjëherë kufirin.

Njëra ndër taktikat më të suksesshme, për t'u mbrojtur nga tipi që vuan nga çrregullime narciste të personalitetit, është vendosja e menjëhershme e kufirit me atë, që në minutën e parë.

Për ta arritur një gjë të tillë, duhet ndjekur kjo radhë pune:

Mos lejo që, narcisti, të vendosë prioritetet e veta mbi të tuat.

Mos lejo që, ai, të marrë vendim për ty, në kundërshtim me interesat dhe vullnetin tënd.

Bëja të qartë dhe, vendosmërisht, çfarë guxon të thotë dhe të bëjë, në prezencën tënde.

Tregohu vigjilent në shenjat që ai të jep, me qëllim që të të manipulojë.

Jepi të kuptojë që, ai, nuk është më shumë dhe, as më pak se ti dhe, të tjerët.

Nëse e kupton se, ai, mundohet të ndryshojë personalitetin tënd, dëshirat dhe vullnetin, duhet të ndahesh nga ai.

Këto janë vetëm disa ide, për mënyrën si duhet të reagosh përballë tipit narcist.

Rëndësi ka fakti që, ti të bindesh që, për

jetën tënde, vendose vetëm ti dhe, askush tjetër.

5. Mos prano të manipulohesh dhe, të heshtësh mendimin tënd.

Njëra ndër veçoritë më tipike të tipit narcist është, manipulimi i të tjerëve, për të arritur qëllimet e veta. Për humbjet dhe dhembjet që u shkaktojnë të tjerëve, nuk ndiejnë dhembje as mëshirë. Shumë prej tyre, janë ekspert, për një gjë të tillë.

E rëndësishme është, njohja e një situatë të tillë. Arti i manipulimit nga narcistët, ka shumë fytyra. Shumë prej tyre tregohen të durueshëm, e bëjnë „shpërthimin“ me djegie të ngadalshme. Megjithatë, ai nuk heq dorë nga qëllimi i tij final, manipulimi i tjetrit. Ai vazhdon të provojë që, të ndryshojë zakonet, idetë, qëllimet, dëshirat dhe veprimet e tua.

P.sh. ai provon që të ndryshojë stilin dhe llojin e veshjes tënde. Nëse është besimtar fanatik, ai provon të të bind që të mbash shami në kokë, madje, edhe ferexhe.

Jo, jo, nuk duhet të pranosh! Ti nuk duhet ta ndryshosh kurrë mendimin tënd, mbi të gjitha nëse është fjala për principet e tua bazë, për idealet, për lirinë dhe të drejtat e tua.

## 6. Lagia „barutin“.

Një mënyrë tjetër për ta neutralizuar narcistin, është bllokimi i aftësive të tij, lagia e „barutit“.

Më sipër, kemi thënë që, mënyra më e mirë për të shpëtuar nga tipi narcist, është injorimi i tij. Por, jo në të gjitha rastet mund të injorohet. Nëse ke të bësh direkt me një tip të tillë, në familje, miqësi apo punë, injorimi nuk është i lehtë.

Në raste të tilla, ti, mund ta mposhtësh atë, me aftësitë e tua, mendore, profesionale dhe rezistencë.

Nëse ai e kupton se ka të bëjë me një njeri të aftë, profesionalisht, të ditur dhe të pathyeshëm, e ulë „pushkën“, fillon të mendojë disi ndryshe.

Nëse i thua narcisin se, nuk je aq atraktiv, se ti njeh njerëz të mençur dhe inteligjentë, se, në disa drejtime je më i aftë se ai, e ngutet psikikisht. Rëndësi ka që, ato që ia thua, të jenë të vërteta.

## 7. Trego aftësitë e tua.

Tipi narcist, nuk mposhtet me grindje dhe nervozitet. Mjete më i mirë, për ta mposhtur atë, janë aftësitë e tua. Dhe, ti, duhet t'ia tregosh atij, në çdo rast. Duhet të guxosh t'ia tregosh aftësitë e tua, pa druajtje dhe ndrojtje. Nëse ai të mburret me kualifikimin dhe studimet e veta, edhe ti, tregoja menjëherë shkallën tënde të kualifikimit dhe studimet e tua.

Këto shtatë mënyra, të rekomanduara për neutralizimin e tipit narcist, janë edhe „terapi“ për narcistin. Narcizmi është një çrregullim psikik i cili, me ndihmë profesionale, edhe mund të përmirësohet. Pritshmëria nuk është e madhe pasi, bëhet fjalë për një problem kompleks.

**Lekë Imeraj**

shkrimtar, përkthyes, publicist





\*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\*



Dashamir Dini

**NË THETH...**

Aty,  
dielli lind në folenë e maleve ditëve  
dhe erërat e marrin  
e ngjesin në qiell.  
Aty,  
hënën mund ta përkëdhelësh netëve  
dhe t'i thuash:-Të dua!  
Aty,  
yjet mund t'i thërrasësh me emra,  
e t'u flasësh,me "ti".  
Aty,  
gjelbërimi lind nga dashurija e shkëmbit  
e shndërrohet në pyll.  
Aty,  
lumi rrjedh nga legjendat  
e shkon e bëhet det.  
Aty,  
në vend të dyerve,  
njerzit  
çelin zemrat.  
Aty...  
Thonë,  
se aty,  
Zoti,  
uli Parajsën.  
Qielli  
është aq pranë,  
saaa,  
mund të takosh edhe engjëjt.

**ERDHËN LULET...**

Erdhën  
dhe lulet.  
Jeta mori  
fytirën e bukur  
të një femre  
pas lindjes.  
I kemi pritur  
nga herë...  
Për të mos ua harruar emrat,  
me emrat e tyre  
kemi pagëzuar fëmijët.

Për të mos ua harruar ngjyrat,  
me ngjyrat e tyre  
kemi ngjyrosur  
ëndrrat e fëmijëve.  
Erdhën lulet.  
...Dhe ne  
i thërrasim,  
me emrat  
e fëmijëve.  
Dashamir Dini.

**LEGJENDA JEME...**

Kur kam lind,  
jam beku  
në shtretin  
e 5 ujnave.  
Nji natë,më ka përkund  
në shtratin e saj,Buna,  
një natë,më ka marr në shtratin e vet  
e ka luft me mu Liqeni,  
nji natë,më ka mbajt në krahë  
tuj m'përkdhel Kiri,  
nji natë,me ka këndu ninulla  
deri që doli dielli me m'kërku,Drini,  
e nji natë,deti,  
më ka mbulu në shtratin e vet me përqa-  
fime  
valësh.  
Prej aty,  
flladet  
më kanë çu  
me pi 5 pika të bardha qumësht  
në gjoksin prej guri të Rozafës,  
për me m'ba të fort  
sa me mbajt  
mbi shpindë  
tana hallet e botës.  
E në fund,  
nji plak i moçëm legjendash,  
dal prej mjegullash,  
erdhi e më tha:  
-Tash mëso vetëm me qesh,  
në daç me kenë tamam shkodranë...  
....Atëherë,  
Zoti jem asht ul prej qiellit,

e m'ka pagëzu,  
tuj më pëshpërit 5 herë në vesh  
emnin SHKODRAN.

**UNË KAM NJË MIJË NGJYRA...**

Unë kam një dhëmbje  
dhe një mijë ngjyra.  
Njëmijë ngjyra,  
me të cilat  
mbuloj pikëllimin tim.  
Kur mëngjeset e mija  
çelen të vrënjtura,  
unë i ngjyros me të kaltër  
dhe pikturoj  
diej të gëzuar.  
Kur netët  
më vinë  
errësisht të verbëra,  
i ngjyros me hënë  
dhe u pikturoj  
sy vezullues yjesh.  
Unë kam  
një mijë ngjyra,  
me të cilat pikturoj gëzimin  
mbi dhëmbjen time.  
Sa herë dhëmbja  
përpiket të ma ngjyros fytirën  
me trishtimin e lotëve...  
Unë,  
vizatoj një buzëqeshje.

**ARGËTIMI I PENSIONISTIT...**

Don të bësh qejf  
pa paguar?!  
Ëndërro!  
Nuk ke nevojë për aeroport,  
as për biletë,  
as për pilot,  
as për stjuardesa,  
as për avion që,të fluturosh.  
Thjeshtë merr një kafe  
dhe thuaji mendjes,  
jam gati.  
Mund të shëtisësh gjithë botën  
pa mbaruar kafënë,  
nga Plazhet e Dubait  
deri në plazhet e Maldiveve,  
e të kthehesh në kohë  
për të bërë pazarin  
që të ka lënë porosi gruaja,  
e pastaj,

të mbërrish i lumtur në shtëpi  
pa u shtruar dreka...  
Thjeshtë  
ëndërro!  
Se do mund të shëtisësh gjithë botën...  
E në fund!  
Do dorëzosh të paprekur  
edhe gjithë pensionin,tek gruaja.  
Hahaha!  
Sa qejf!

**SHKRUAR, MË, 21 MARS...**

Shushurimat e gjetheve të sapolindura  
nga shtatëzaniya sytheve,  
gjelbëroj drurët.  
Hiti  
i dallëndysheve  
të sapodalura nga veza e artë e diellit,  
thërret me emra lulet.  
Pranvera  
shembi  
qelitë e zymla të vetmive...  
Dimri ra.  
Lirija  
me sytë ngjyrë qielli  
të ditës sësapoardhur,  
na thërret me emra,njerëz...  
...Tashmë,  
mund të fluturojmë...

**JETA VAZHDON TË JETË DIÇKA E DASHURUESHME...**

Koha s'më premtion më!  
Më kishte premtuar aq shumë dikur  
dhe më kishte realizuar aq shumë,  
sa mendoja  
se vdekja ishte një figurë letrare.  
Tashti  
numëroj çastet,  
si paratë e fundmuajit.  
Dikur ecja nëpër tokë,  
e kur lumturohesha  
fluturoj edhe nëpër qiell.  
Tashti më nervozon  
fluturimi i zogjve...  
Jeta vazhdon të jetë  
diçka e dashurueshme..  
Edhe pse koha,  
s'më premtion më...  
si dikur!

Mundësoj botimin e këtij numri, biznesmeni **Kolë Sukullari**  
Biznesmeni Kolë Sukullari, është një nder anëtarët e rinj të Shoqatës Atdhetare  
"Dukagjini", rrjedh nga një familje me tradita të lashta patriotike dhe kulturore të  
krahinës së Shoshit dhe të zonës së Dukagjinit. Kola, është një djalë energjik, pu-  
nëtor dhe bujar, që jeton midis emigracionit dhe vendlindjes. Një nga familjet që  
asnjëherë nuk u shkëput nga trojet shekullore, atje tek kulla e lashte dhe e bukur në  
fshatin Pylaj të Shoshit. Një nga iniciatorët dhe personat më aktiv të lëvizjes për  
Rrugën e Dukagjinit. Tani edhe një mundësori i gazetës tonë "Dukagjini".  
Faleminderit!  
Urojme që të kemi pran vetes sa më shumë djem të tillë!  
T'u rrit ndera dhe suksese në jetë, në punë dhe familjen tuaj!  
**Redaksia**

**REDAKSIA**  
Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**  
Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,  
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan  
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon  
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin:  
**KOLË SUKULLARI,**  
Pylaj, Shosh